



Shqipëri Studim për Përdorimin e Kohës 2010-11

Dhjetor 2011

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Shqipëria

Studimi i Përdorimit të Kohës 2010-2011

Instituti i Statistikës

Tiranë, Shqipëri

Dhjetor 2011



MINISTRIA E PUNËS
ÇËSHTJEVE SOCIALE DHE SHANSEVE TË BARABARTA



Republika e Shqipërisë
Instituti i Statistikës



United Nations
ALBANIA

Raporti u shkrua nga:

Pranvera Elezi, INSTAT Shqipëri

Klas Rydenstam, Konsulent Ndërkombëtar

Linku i Studimit Kombëtar të Përdorimit të Kohës: www.instat.gov.al

Adresa: INSTAT

Telefon: +355 4 2222411

E-mail: botim_difuzion@instat.gov.al



Ky studim është mbështetur nga Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullsinë (UNFPA) dhe Agjencia e Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave (UN Women).

Opinionet dhe pikëpamjet e shprehura në këtë raport jo domosdoshmërisht reflektojnë ato të UNFPA-së dhe UN Women.

ISBN: 978-9928-124-29-6

Shtypi: shtypshkronja PEGI

Lundër, Tiranë

Falenderime

Ky studim është produkt i një bashkëpunimi të ngushtë mes disa institucioneve.

Dëshirojmë të falenderojmë Fondin e Kombeve të Bashkuara për Popullsinë (UNFPA), Agjensinë e Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave (UN Women), dhe projektet Kombëtare dhe Rajonale të Sida-s për sponsorizimin dhe mbështetjen e këtij studimi.

Gjithashtu dëshirojmë t'u shprehim falenderimet dhe mirënjohjen tonë anëtarëve të grupit teknik të punës nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, të Universitetit të Tiranës dhe organizatat e shoqërisë civile, të cilët kanë dhënë një ndihmë dhe mbështetje të paçmuar.

Falenderime të veçanta shkojnë për ekspertët e INSTAT-it, intervistuesit dhe grupet e punës së cilësisë së të dhënave për kontributin e vyer. Pranvera Elezi, manaxhere e projektit të TUS, ka qenë një person kyç në suksesin e këtij projekti. Gjithashtu vlerësojmë me mirënjohje kontributin e Liljana Boçi (metodologjiste) dhe Florian Nika (ekspert IT).

Dëshirojmë gjithashtu t'u shprehim falenderimet dhe mirënjohjen tonë Konsulentëve Ndërkombëtarë, Klas Rydenstam dhe Richard Öhrvall. Ndihma e tyre në përpunimin e të dhënave ka qenë me vlerë, duke pasur parasysh kompleksitetin e të dhënave për përdorimin e kohës. Angazhimi i Klas Rydenstam edhe në shkrimin e raportit ishte një ndihmesë e madhe për projektin.

Së fundi, dëshirojmë të falenderojmë familjet që kanë marrë pjesë në këtë studim, të cilat kanë vënë në dispozicion kohën e tyre për t'iu përgjigjur pyetjeve të studimit dhe për të plotësuar ditarët.

Rezultatet kryesore.....	6
1 Hyrje	7
1.1 Objektivat e studimit.....	7
1.2 Përmbajtja e raportit.....	8
2 Metodika	9
3 Struktura shqiptare e përdorimit të kohës	10
3.1 Një vështrim i shkurtër ndërkombëtar.....	13
3.2 Struktura e përdorimit të kohës sipas ditëve të javës.....	18
3.3 Struktura e përdorimit të kohës sipas moshës.....	20
3.3.1 Të gjitha ditët	20
3.3.2 Ditët e javës dhe fundjavës.....	21
3.4 Struktura e përdorimit të kohës në zonat urbane dhe rurale	26
3.5 Struktura e përdorimit të kohës kur ke fëmijë	26
3.6 Struktura e përdorimit të kohës sipas statusit të punësimit	27
4 Përdorimi i kohës me më shumë hollësi.....	29
4.1 Puna e papaguar	29
4.1.1 Mosha dhe gjinia	29
4.1.2 Zonat urbane dhe rurale.....	33
4.1.3 Të pasurit fëmijë	34
4.1.4 Statusi i punësimit	37
4.2 Koha e lirë	38
4.2.1 Mosha dhe gjinia	38
4.2.2 Zonat urbane dhe rurale.....	42
4.2.3 Të pasurit fëmijë	43
4.2.4 Statusi i punësimit	46
5 Aspekte të mëtejshme të përdorimit të kohës në Shqipëri.....	48
5.1 Kujdesja për fëmijët	48
5.2 Konteksti social	50
5.3 Vendndodhja.....	54
5.4 Ritmi ditor	58
5.5 Turni i dytë i femrave	64
5.6 Fragmentarizimi i kohës së lirë.....	65

Anekset.....	67
Shtojca A.....	67
Shtojca B.....	129
Shtojca C.....	136
Shtojca D	140

Rezultatet kryesore

Ky studim merret me përdorimin e kohës në Shqipëri për popullsinë 10 vjeç e lart në periudhën nga Marsi 2010 dhe 12 muajt pasues.

Përdorimi i kohës në Shqipëri lidhet ngushtë me gjininë e personave sa i përket punës dhe kohës së lirë.

Si puna e paguar, ashtu edhe puna e papaguar janë aktivitete prodhuese dhe janë shumë të rëndësishme për ekonominë dhe mirëqenien. Që të dyja kontribuojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë që familja të mund të përballojë jetesën.

Meshkujt kalojnë shumë më tepër kohë sesa femrat duke kryer punë të paguar, si përsa i përket numrit të orëve dhe minutave, ashtu edhe shkallës së pjesëmarrjes në kryerjen e punës së paguar në një ditë mesatare.

Femrat kalojnë shumë më tepër kohë duke kryer punë të papaguar, si përsa i përket numrit të orëve dhe minutave, ashtu edhe përqindjes të personave që kryejnë punë të papaguar në një ditë mesatare.

Nga totali i punës së papaguar të kryer nga popullsia 10 vjeç e lart, meshkujt kryejnë 14 përqind, kurse femrat 86 përqind. Kjo është një shpërndarje shumë e pabarabartë si në terma absolutë, ashtu edhe në terma relativë krahasuar me vende të tjera evropiane.

Edhe mes të rinjve (10-14 vjeç) dhe të moshuarve (65 vjeç e sipër), shpërndarja e punës së papaguar është shumë e pabarabartë, ndonëse më e moderuar.

Sa i përket punës së paguar dhe të papaguar të marra së bashku, d.m.th. punës totale, kontributet e grave në kohë e tejkalojnë kontributin e burrave me afërsisht dy orë në një ditë mesatare. Nga këndvështrimi evropian, kjo diferencë është e madhe.

Diferenca prej dy orësh mes dy gjinive sa i përket punës, ekuilibrohet kryesisht nëpërmjet një difference në kohën e lirë. Meshkujt kanë mesatarisht një orë e gjysmë më shumë kohë të lirë se femrat. Pjesa e mbetur prej gjysmë ore lidhet me vaktet/kafetë, kryesisht në restorante.

Si femrat, ashtu edhe meshkujt në zonat rurale, shpenzojnë më shumë kohë duke punuar sesa në zonat urbane. Grupi i vetëm që shpenzon më shumë orë në punë totale – përfshirë ditët e javës dhe fundjavat – është ai i femrave në zonat rurale.

Të pasurit fëmijë më të vegjël se 7 vjeç ndikon shumë tek mënyra se si femrat e përdorin kohën. Ato bëjnë shumë më pak punë të paguar dhe shumë më tepër punë të papaguar krahasuar me femrat me fëmijë më të rritur.

Për meshkujt, kjo diferencë nuk ekziston pothuajse fare, shumë pak ndikon fakti nëse kanë apo jo fëmijë të vegjël tek mënyra se si e përdorin kohën ata.

Punët kryesore të shtëpisë si gatimi, larja e enëve, pastrimi dhe mirëmbajtja e shtëpisë, larja e rrobave dhe hekurosja janë të lidhura jashtëzakonisht shumë me gjininë. Nga gjithë numri i orëve që popullsia e moshës 15-64 vjeç shpenzon për këto aktivitete, femrat kryejnë 96 përqind të tyre, meshkujt 4 përqind. Të pasurit fëmijë të vegjël e bën shpërndarjen edhe më të pabarabartë.

Qysh prej fillimit të viteve 1990, kërkesa dhe interesi për statistika lidhur me përdorimin e kohës është rritur në gjithë botën. Në Evropë, EUROSTAT-i ka vlerësuar nevojën për një krahasueshmëri më të madhe midis studimeve kombëtare për përdorimin e kohës dhe në fillim të viteve 1990 filloi një projekt, që kishte për qëllim harmonizimin e statistikave për përdorimin e kohës në Evropë. Si rezultat, kur 15 vende evropiane kryen disa studime për përdorimin e kohës rreth vitit 2000, ato aplikuan një version të mëparshëm të Udhëzimeve të Harmonizuara Evropiane të EUROSTAT-it për studimet për përdorimin e kohës (HETUS). Mbi bazën e përvojës nga këto studime, Udhëzimet HETUS u rishikuan dhe u publikuan në vitin 2008.

Ky është raporti për studimin shqiptar të vitit 2010 për përdorimin e kohës, i cili aplikon udhëzimet e HETUS-it dhe ka kështu aftësinë të prodhojë rezultate të krahasueshme në shkallë ndërkombëtare.

1.1 Objektivat e studimit

Qëllimi kryesor i studimit shqiptar për përdorimin e kohës është që të zhvillojë vlerësime përfaqësuese në rang kombëtar për mënyrën se si e ndajnë njerëzit kohën e tyre për aktivitetet e ndryshme të jetës. Objektivat kryesore që duhet të arriheshin përmes këtij studimi për përdorimin e kohës ishin:

- matja e sasisë së kohës së shpenzuar nga popullsia shqiptare për aktivitete të ndryshme;
- identifikimi i diferencave gjinore në mënyrat e përdorimit të kohës duke u fokusuar në mënyrë të veçantë tek aktivitetet e punës së paguar dhe të papaguar;
- kryerja e studimit në përputhje të plotë me udhëzimet dhe specifikimet e BE-së me qëllim ofrimin e statistikave të krahasueshme për përdorimin e kohës;
- krijimi i një baze të dhënash të dokumentuara në një format të aksesueshëm dhe të kuptueshëm për t'u përdorur nga studiuesit, akademikët dhe punonjës të qeverisë.

1.2 Përmbajtja e raportit

Raporti përmban 5 seksione. I pari është hyrja. I dyti është një përshkrim shumë i shkurtër teknik i studimit. Shtojca B përmban një përshkrim teknik shumë më të detajuar. Në seksionet 3-5 paraqiten rezultatet kryesore të studimit. Raporti shoqërohet edhe nga disa shtojca. Përveç përshkrimit teknik, është edhe një shtojcë në formë tabele (Shtojca A) dhe një shtojcë (Shtojca D) me informacione dhe ndihmë për të kuptuar më mirë natyrën e të dhënave për përdorimin e kohës dhe vlerësimeve për përdorimin e kohës, pasi ato ndryshojnë ndjeshëm nga shumica e studimeve të tjera statistikore. Shtojca D jep edhe informacione të caktuara teknike për projektimin e studimit në HETUS. Është edhe një shtojcë tjetër (Shtojca C), e cila jep informacion rreth sistemeve të ndryshme të kodimit që përdoren në studim.

Të dhënat për përdorimin e kohës janë shumë të pasura me informacion. Çdo raport për një studim mbi përdorimin e kohës do të përdorte vetëm një pjesë të vogël nga gjithë informacioni që përmban në të vërtetë studimi. Kështu ndodh edhe me këtë raport. Përzgjedhja e çështjeve të trajtuara bazohet tek objektivat kryesore të studimit. Shpresohet që çështjet e adresuara të ofrojnë edhe disa ide sa i përket informacionit të mëtejshëm që mund të nxirret, pasi ky raport nuk trajton, dhe nuk mund ta trajtojë, në mënyrë të barabartë të gjithë paketën e të dhënave të mbledhura.

Ka tre seksione me përmbajtje shumë të rëndësishme. I pari përshkruan mënyrën se si e përdorin shqiptarët kohën në terma të përgjithshëm; aktivitetet grupohen në disa kategori dhe ndahen sipas disa variablave klasifikues; gjinia, grupmosha, zonë urbane/rurale, statusi i punësimit dhe situata familjare sa i përket numrit të fëmijëve dhe moshës së tyre. Ndonjëherë, rezultatet për ditët e javës ndahen nga ditët e fundjavës. Meqenëse ky dallim në Shqipëri duket se është relativisht i kufizuar, kjo ndarje nuk është bërë në të gjithë studimin. Ky seksion përmban edhe një vështrim ndërkombëtar. Për llogaritjen e rezultateve të krahasueshme për tre vende të tjera evropiane është përdorur instrumenti HETUS për prodhimin e tabelave, i cili operon në Internet dhe mund të përdoret nga kushdo që mund të jetë i interesuar¹. Seksioni i dytë e përshkruan me më shumë hollësi përdorimin e kohës. Aktivitetet janë më të ndara. Dy grupe aktivitetesh fokusohen konkretisht tek puna e papaguar dhe koha e lirë. Në seksionin e tretë trajtohen një sërë çështjesh specifike si p.sh. kujdesi për fëmijët, konteksti social, vendndodhja dhe vendndodhja e përkohshme e aktiviteteve. Në seksionin për vendndodhjen e përkohshme të aktiviteteve përfshihen edhe disa krahasime ndërkombëtare.

1 Për ta përdorur kërkohen kredencialet e regjistrimit, të cilat ofrohen nga Statistics Sweden. Shih <https://www.h2.scb.se/tus/tus/>



METODIKA

Studimi Shqiptar për Përdorimin e Kohës (SSHPK) aplikon udhëzimet e Harmonizuara Europeane të EUROSTAT-it për studimet për përdorimin e kohës (HETUS). Kjo qasje përshkruhet me hollësi në udhëzimet që mund të gjenden në Internet².

Si në HETUS, ashtu edhe në SSHPK, informacioni mbi përdorimin e kohës mbledhet nëpërmjet një ditarit të ndarë në intervale kohe 10 minutëshe, ku vetë të intervistuarit shënojnë se si e përdorin kohën për dy ditë që zgjidhen në mënyrë të rastësishme. Në ditar shënohet një aktivitet kryesor, një aktivitet që mund të kryhet paralelisht ose në të njëjtën kohë, vendi ku kryhet aktiviteti, mjeti i transportit, dhe nëse gjatë kryerjes së aktivitetit ka apo jo njerëz të tjerë të pranishëm.

Pak ditë para ditëve të përzgjedhura për mbajtjen e ditarëve, individët u intervistuan sipas dy pyetësorëve që lidheshin me rrethanat familjare dhe individuale.

Studimi për periudhën 2010-11 bazohet tek një kampion përfaqësues prej 2,250 familjesh. Studimi mbulon popullsinë shqiptare nga 10 vjeç e sipër. Çdo anëtar i të familjes në moshën 10 vjeç e lart i'u kërkua të plotësonte pyetësorin individual dhe dy ditarë.

Dy ditët në të cilat do të mbaheshin ditarët, një ditë jave dhe një ditë fundjave, që përfaqësojnë periudhën kohore nga Marsi 2001 dhe 12 muajt pasues, u zgjodhën nëpërmjet një procedure të rastësishme për çdo familje në këtë kampion.

Anketuesit bënë intervistat, udhëzuan të intervistuarit për mënyrën se si duhet të plotësonin ditarët, mblodhën ditarët e plotësuar dhe i dërguan në INSTAT, ku më pas u koduan. Ditarët dhe pyetësorët u transferuan në skedarë të dhënash nëpërmjet disa programeve kompjuterike të projektuar enkas për këtë qëllim. Për përpunimin e të dhënave u përdor instrumenti SPSS (Paketë Statistikore për Shkencëtarët e Shkencave Sociale).

Shtojca B ofron informacione të tjera për çështjet teknike dhe një vlerësim të shkurtër teknik.


² Udhëzimet gjenden këtu:
http://epp.eurostat.ec.europa.eu/cache/ITY_OFFPUB/KS-RA-08-014/EN/KS-RA-08-014-EN.PDF

3

STRUKTURA SHQIPTARE E PËRDORIMIT TË KOHËS

Për të ofruar imazhin më të përgjithshëm statistikor të përdorimit të kohës nga popullsia shqiptare, aktivitetet kryesore janë grupuar në gjashtë kategori: punë e paguar, studime, punë e papaguar, aktivitete personale, kohë e lirë dhe një «tjetër» kategori për ato aktivitete që nuk hyjnë në asnjë nga kategoritë kryesore. Koha për punën e paguar përbën një matje bruto. Në të përfshihen edhe vajtja në punë dhe kthimi prej saj, si dhe pushimet e drekës. Puna e papaguar përfshin p.sh. të gjitha llojet e punëve të shtëpisë, kujdesin për fëmijët, mirëmbajtjen, etj. Që të gjitha këto janë punë produktive, pasi ekziston të paktën teorikisht mundësia që një njeri ose ta blejë një shërbim, ose ta bëjë atë vetë. Fjetja, ngrënia dhe kujdesi për veten klasifikohen si aktivitete personale. Koha e lirë është diçka që i përket një kategorie tjetër, aktivitetet që nuk i përkasin katër kategorive të para gjenden këtu. Kjo kategori përmban lloje të larmishme aktiviteteve që njerëzit bëjnë në kohën e lirë. Ky klasifikim e ka origjinën nga puna e sociologut norvegjez D. Aas³ (Aas, 1972) dhe përdoret gjerësisht në statistikat për përdorimin e kohës në disa variante të ndryshme. Klasifikimi i plotë i aktiviteteve shqiptare, që aplikon Udhëzimet e Harmonizuara Evropiane për Studimet për Përdorimin e Kohës, mund të gjendet në Shtojcën C.

Grafiku 3.1⁴: Koha mesatare e shpenzuar për aktivitetet sipas gjinisë, popullsia shqiptare e moshës 10 vjeç e lart, të gjitha ditët.



3 Aas, D. Studies of Time-Use: Problems and Prospects. Acta Sociologica 1978, Vol 21-No 2

4 Ky grafik bazohet në shifrat e gjetura në Tabelën A.1 në shtojcën A të tabelave

Grafiku 3.1 tregon strukturën e përdorimit të kohës nga popullsia shqiptare e moshës 10 vjeç e lart. Vijat horizontale në grafik përfaqësojnë 24 orët e një dite të zakonshme në Shqipëri gjatë periudhës nga Marsi 2010 dhe në 12 muajt pasues. Tre orë nga 24 orë gjithsej të ditës kalohen duke kryer punë të paguar, përfshirë këtu vajtjen për në punë dhe kthimin nga puna, si dhe pushimet e drekës. Kjo përfaqëson rreth 13 përqind të kohës. Për studime shpenzohet diçka më pak se një orë. Të dhënat përfshijnë edhe pushimet dhe kohën e shkuarjes dhe ardhjes nga studimi. Koha e kaluar duke kryer punë të papaguar është po aq sa edhe koha e kaluar duke kryer punë të paguar, d.m.th. tre orë në ditë. Kështu, gjashtë orë ose 25 përqind e kohës i kushtohet punës, të paguar ose të papaguar. Kategoria e aktiviteteve që konsumon pjesën më të madhe të kohës janë aktivitetet personale me 12 orë, d.m.th fjetja, ngrënia dhe higjiena personale. Kategorisë së kohës së lirë, e cila përbëhet kryesisht nga ato çka në gjuhën e përditshme quhen aktivitete të kohës së lirë, i kushtohen pothuajse pesë orë.

Shprehur në terma relativë, 50 përqind e një dite mesatare në Shqipëri 2010/11, i kushtohet aktiviteteve personale, 25 përqind punës, sasi të njëjta të punës së paguar dhe asaj të papaguar, rreth katër përqind studimit dhe 21 përqind aktiviteteve të kohës së lirë.

Struktura e përdorimit të kohës ndryshon ndjeshëm midis grave dhe burrave shqiptarë. Koha që shpenzojnë femrat duke punuar (d.m.th. puna në total që është shuma e punës së paguar me punën e papaguar) e tejkalon atë të burrave me dy orë në ditë, 7:10 përkundrejt 5:07⁵. Një tjetër mënyrë për ta shprehur këtë është që femrat përbëjnë 58 përqind të numrit total të orëve të shpenzuara për punë totale nga popullsia shqiptare e moshës 10 vjeç e lart, kurse meshkujt 42 përqind. Meqenëse dita ka 24 orë për të gjithë, kjo shpërndarje e pabarabartë duhet të ekuilibrohet me një diferencë korresponduese në një apo në më shumë kategori aktiviteteve të tjera. Kështu, meshkujt kanë një orë e gjysmë më shumë kohë të lirë në ditë (5:35 përkundrejt 4:08) dhe një gjysmë ore më shumë për aktivitete personale (11:39 përkundrejt 12:13).

Lloji i punës që bëjnë femrat dhe meshkujt është gjithashtu shumë i lidhur me gjininë. Nga numri total i orëve të punës së paguar të popullsisë shqiptare të moshës 10 vjeç e lart, meshkujt zënë 70 përqind, kurse femrat 30 përqind. Ndarja e punës së papaguar është edhe më e lidhur me gjininë, pasi femrat zënë 86 përqind, kurse meshkujt vetëm 14 përqind; dhe siç u përmend më sipër, për të dyja llojet e punës të marra së bashku, shpërndarja është 58 përkundrejt 42 përqind.

Numrat e dhënë më sipër mbulojnë të gjitha grupet e popullsisë. Ato janë parimisht totale për grupet – në këtë rast, femrat dhe meshkujt – të zërthyer në nivel individual. Ato nuk tregojnë asgjë (ose të paktën shumë pak) rreth sjelljes individuale nëse nuk ka informacione rreth shpërndarjes brenda grupeve. Një matje e tillë e shpërndarjes, e cila është edhe një ndër matjet standarde të prodhuara nga studimet për përdorimin e kohës është shkalla e pjesëmarrjes. Kjo matje jep informacione rreth raportit të individëve në një grupmoshë, që i kushtojnë të paktën njëfarë kohe një aktiviteti të veçantë gjatë një dite të zakonshme.

5 Kur koha shkruhet në formatin xx:yy, tregohen orët dhe minutat.

Tabela 3.1: Përqindjet e popullsisë që kryejnë aktivitete⁶ sipas gjinisë, popullsia shqiptare e moshës 10 vjeç e sipër, të gjitha ditët

	Femra	Meshkuj	Të gjithë
	<i>Përqindje (%)</i>		
Punë e paguar	32	56	44
Studime	14	15	14
Punë e papaguar	91	40	66
Aktivitete personale	100	100	100
Kohë e lirë	97	99	98
Të tjera	7	6	6

Sic mund të pritej, Tabela 3.1 tregon se të gjithë meshkujt dhe femrat konsumojnë një sasi kohe me aktivitetet personale gjatë një dite të zakonshme. Pothuajse të gjithë bëjnë aktivitete në kohën e lirë. Rreth 15 përqind e kohës i kushtohet studimeve, pa asnjë lloj difference të regjistruar midis femrave dhe meshkujve. Megjithatë, puna midis gjinive ndryshon; është një numër shumë më i madh meshkujsh në krahasim me femrat që kryejnë punë të paguar (56 përkundrejt 32 përqind). Kur vjen fjala tek puna e papaguar, ndodh e kundërta, janë femrat ato që në një numër shumë më të madh se meshkujt kryejnë punë të papaguar (91 përkundrejt 40 përqind).

Një hap tjetër për të kuptuar më mirë sjelljen individuale do të ishte llogaritja e kohës së shpenzuar në ato aktivitete nga të intervistuarit që shënuan në ditarët e tyre se ata u kushtonin kohë atyre aktiviteteve, p.sh. numri i orëve që kanë punuar njerëzit që janë në punë.

Tabela 3.2: Koha mesatare për aktivitetet për të intervistuarit që i kryejnë këto aktivitete⁷ sipas gjinisë, popullsia shqiptare e moshës 10 vjeç e sipër, të gjitha ditët

	Femra	Meshkuj	Të gjithë
	<i>Mesatarja në orë dhe minuta (hh:mm)</i>		
Punë e paguar	06:11	07:39	07:07
Studime	06:53	06:32	06:42
Punë e papaguar	05:43	02:06	04:37
Aktivitete personale	11:39	12:13	11:56
Kohë e lirë	04:17	05:40	04:58
Të tjera	01:07	01:22	01:14

Tabela tregon se ditët e punës së paguar të meshkujve janë mesatarisht rreth një orë e gjysmë më të gjata sesa ato të femrave (7:39 përkundrejt 6:11 orë), kurse ditët e punës së papaguar të femrave janë shumë më të gjata sesa ato të meshkujve (5:42 përkundrejt 2:06 orë). Ekziston gjysmë ore diferencë sa i përket kohës kushtuar studimeve. Meqenëse shkalla e pjesëmarrjes është 100 ose pothuajse 100 përqind për aktivitetet personale dhe kohën e lirë, mesataret në Tabelën 3.2 janë pothuajse të njëjta ose të përafërta me mesataret sipas GrafikuGrafikut 3.1 më sipër.

6 Shkalla e pjesëmarrjes.


7 Kjo mesatare përbën raportin midis mesatares së përgjithshme të pjesëtuar me shkallën e pjesëmarrjes, shprehur në intervalin 0 deri në 1, d.m.th. përqindja e pjesëtuar me 100.

3.1 Një vështirësi i shkurtër ndërkombëtar

Imazhi statistikor i prezantuar më sipër tregon diferencat e qarta gjinore sa i përket punës dhe kohës së lirë në Shqipëri. Një mënyrë për të vlerësuar sesa e madhe është kjo diferencë është që të krahasohen rezultatet e situatës korresponduese në disa vende të tjera evropiane. Instrumenti HETUS⁸ na ofron mjetet për ta bërë këtë. Problemi është se të dhënat në instrumentin HETUS janë rreth 10 vjeçare. Megjithatë, kjo nuk e çënon krahasimin pasi mënyrat se si njerëzit e përdorin kohën ndryshojnë në mënyrë të ngadalshme⁹.

Tre vende janë zgjedhur për këtë qëllim, një në Ballkan (Sllovenia), një tjetër në Evropën Jugore (Italia) dhe një në bllokun Nordik (Suedia). Për krahasim, popullsia e përzgjedhur do të jetë grupmosha 20-74, që është edhe popullsia që zë pjesën më të madhe në të 15^{të} vendet e bazës së të dhënave HETUS.

Grafiku 3.2¹⁰: Koha mesatare e shpenzuar për aktivitete sipas gjinisë dhe vendit, popullsia 20-74 vjeç, të gjitha ditët.



Struktura shqiptare e përdorimit të kohës në Grafikon 3.2 (për popullsinë 20-74 vjeç) është në pjesën e saj më të madhe e njëjtë si në Grafikon 3.1 (për popullsinë 10 vjeç e sipër). Në Grafikon 3.2, koha për punë është pak më e gjatë, kurse për studime pak më e shkurtër, pasi përjashtohen personat shumë të rinj në moshë. Diferencat gjinore janë pothuajse të njëjta.

Një vëzhgim i parë nga Grafiku 3.2 është se mes vendeve ka diferenca relativisht të vogla kur bëhet fjalë për përbërjen dhe për kohën totale të punës. Koha totale për

8 Shih <https://www.h2.scb.se/tus/tus/>

9 Shembull: Studimi suedez për përdorimin e kohës i vitit 2010 ndryshon shumë pak nga studimi i vitit 2000 sa i përket çështjes së trajtuar këtu. Ky ndryshim i vogël tregon se gratë dhe meshkujt janë bërë pak më shumë të ngjashëm sa i përket punës së paguar dhe punës së papaguar.

10 Ky grafik bazohet në shifrat e gjetura në Tabelën A.9 në shtojcën tabelë.

punë është rreth 8 orë ose pak më pak. Nga ana tjetër, ka disa diferenca në sasinë e kohës së lirë. Megjithatë, diferencat ekuilibrohen nga diferencat paralele në kohën për aktivitetet personale.

Kur struktura ndahet sipas gjinisë, dalin në pah diferenca të konsiderueshme. Diferencat gjinore në sasinë e kohës për punën e paguar janë nga një orë e gjysmë deri në dy orë në Slloveni dhe Suedi, në Shqipëri tre orë dhe në Itali 20 minuta më pak (shih Tabelën 3.3). për punën e papaguar, diferencat gjinore në vende të ndryshme janë edhe më të mëdha dhe kalojnë në kahun e kundërt. Femrat shpenzojnë shumë më tepër kohë se meshkujt duke kryer punë të papaguar. Diferenca në Suedi dhe Slloveni është dy deri në dy orë e gjysmë. Në Itali është pothuajse katër orë, kurse në Shqipëri pak më shumë se pesë orë. E përkthyer në pjesë të kohës totale konsumuar për punë të papaguar nga popullsia e moshës 20-74 vjeç, meshkujt në Shqipëri zënë 14 përqind, meshkujt në Itali 25 përqind, kurse meshkujt në Slloveni dhe Suedi 36 përqind.

Mes katër vendeve, meshkujt shqiptarë shpenzojnë më shumë kohë nga të gjithë për të kryer punë të paguar dhe kohën më të vogël për punë të papaguar. Sa i përket punës së papaguar, diferenca është jashtëzakonisht e madhe: meshkujt në Slloveni shpenzojnë pothuajse tre orë në ditë, në Suedi pak më pak, kurse në Shqipëri një orë në ditë. Pra, diferenca midis shqiptarëve dhe sllovenëve është mesatarisht dy orë në ditë. Italia qëndron midis Sllovenisë dhe Shqipërisë. Këto diferenca reflektohen edhe në shkallët e pjesëmarrjes: më shumë sesa dyfishi i suedezëve dhe pak më pak burra italianë dhe sllovenë shpenzojnë njëfarë kohe për punë të papaguar gjatë një dite të zakonshme krahasuar me meshkujt shqiptarë. Për Femrat, diferencat kombëtare në punë të paguar janë relativisht të vogla. Megjithatë, nuk ndodh kështu me punën e papaguar, femrat shqiptare shpenzojnë më shumë nga të gjitha për punën e papaguar, 6 orë, pak më pak në Itali dhe më pak se 5 orë në Slloveni dhe Suedi.

Një shpjegim për faktin se meshkujt shqiptarë shpenzojnë relativisht më shumë kohë për punë të paguar sesa homologët e tyre italianë, sllovenë dhe suedezë është se një pjesë shumë më e madhe e meshkujve shqiptarë punojnë fundjavave. Tabela 3.4 tregon se 69 përqind e burrave shqiptarë (20-74 vjeç) punojnë në një ditë të zakonshme, kurse përgjigjet korresponduese për meshkujt në vendet e tjera janë të të ulëta. Duke i ndarë të dhënat sipas ditëve të javës, dalin në pah diferenca të konsiderueshme, 74 përqind e burrave shqiptarë 20-74 vjeç konsumojnë kohë duke bërë punë të paguar ditët e javës dhe 54 përqind fundjavave (tabela A.10 në shtojcën A). Për Italinë, shifrat korresponduese janë 63 dhe 27 përqind, për Slloveninë 59 dhe 25 përqind, kurse për Suedinë përkatësisht 66 dhe 18 përqind¹¹. Ndonëse më pak e theksuar, ka edhe një diferencë paralele për Femrat.

Puna e paguar dhe ajo e papaguar mbledhen për të dhënë punën totale, d.m.th. kohën e shpenzuar për aktivitete produktive. Diferencat kombëtare gjinore në kohë për punën totale variojnë nga më pak sesa një çerek ore në Suedi deri në më shumë sesa një orë në Itali dhe Slloveni dhe më shumë sesa dy orë në Shqipëri. Në të gjitha rastet, koha e femrave ia kalon kohës së meshkujve.

11 Burimi: Instrumenti HETUS i disponueshëm në internet, i cili ofron një mjet lehtësisht të aksesueshëm për prodhimin e statistikave të përdorimit të kohës për 15 vende evropiane. Shih <https://www.h2.scb.se/tus/tus/>

Tabela 3.3: Koha mesatare e konsumuar për aktivitete sipas gjinisë dhe vendlindjes, popullsia e moshës 20-74 vjeç, të gjitha ditët

	Shqipëri			Itali			Slloveni			Suedi		
	Femra	Meshkuj	Të gjithë	Femra	Meshkuj	Të gjithë	Femra	Meshkuj	Të gjithë	Femra	Meshkuj	Të gjithë
	Mesatarja në orë dhe minuta (hh:mm)											
Punë e paguar	02:27	05:25	03:54	02:07	04:47	03:25	02:58	04:14	03:35	02:41	04:40	03:52
Studim	00:14	00:10	00:12	00:16	00:12	00:14	00:21	00:17	00:19	00:10	00:10	00:19
Punë e papaguar	06:00	00:57	03:32	05:44	01:53	03:51	05:16	02:55	04:07	04:47	02:40	03:30
Aktivitetet personale	11:22	12:06	11:44	11:12	11:16	11:14	10:32	10:31	10:31	10:43	10:22	10:25
Kohë e lirë	03:49	05:15	04:31	04:33	05:41	05:06	04:50	05:59	05:24	05:28	05:58	05:43
Të tjera	00:05	00:03	00:04	00:09	00:11	00:10	00:03	00:04	00:04	00:11	00:10	00:11
Punë në total	08:27	06:23	07:26	07:51	06:40	07:16	08:14	07:09	07:42	07:28	07:20	07:22

Tabela 3.4: Përqindja e popullsisë që kryejnë aktivitete sipas gjinisë dhe vendit, popullsia 20-74 vjeç, të gjitha ditët

	Shqipëria			Italia			Sllovenia			Suedia		
	Femra	Meshkuj	Të gjithë	Femra	Meshk	Të gjithë	Femra	Meshkuj	Të gjithë	Femra	Meshkuj	Të gjithë
	<i>Përqindje (%)</i>											
Punë e paguar	38	69	53	28	53	40	39	49	44	40	52	46
Studim	4	3	3	5	4	4	8	7	7	8	5	7
Punë e papaguar	96	43	70	96	71	83	97	84	91	99	92	95
Aktivitetet personale	100	100	100	100	100	100	100	100	100	100	100	100
Kohë e lirë	96	98	97	98	99	98	98	99	98	100	99	99
Të tjera	8	6	7	17	23	20	10	11	11	25	28	27

Femrat në Shqipëri konsumojnë kohën më të madhe në këto tre vende për punën në total, pasuar sipas radhës nga Sllovenia, Italia dhe Suedia. Diferenca midis grave shqiptare dhe suedeze është një orë, 6:23 përkundrajt 7:20. Sllovenia dhe Italia qëndrojnë në mes. Për meshkujt situata është e kundërt, Meshkujt suedezë janë ata që konsumojnë kohën më të madhe për punën në total, 7:20 orë, kurse shqiptarët një orë më pak. Italia dhe Sllovenia ndodhen në mes, Italia është më afër Shqipërisë, kurse Sllovenia më afër Suedisë.


Sa i përket kohës së konsumuar për aktivitete personale, d.m.th. fjetjes, ngrënies dhe kujdesit personal, ka diferenca të konsiderueshme. Popullsia shqiptare, sidomos meshkujt, kalon më shumë kohë për këto aktivitete krahasuar me vendet e tjera. Për meshkujt, diferenca është një me një orë e gjysmë, për femrat më pak e krahasueshme me Slloveninë dhe Suedinë. Shqiptarët flenë më shumë dhe harxhojnë më shumë kohë duke ngrënë, sidomos krahasuar me Slloveninë dhe Suedinë. Nga ana tjetër, si femrat ashtu edhe meshkujt në Shqipëri kanë më pak kohë të lirë, diferenca për meshkujt është rreth gjysmë deri në një orë. Për femrat diferenca është deri në një orë e gjysmë.

3.2 Struktura e përdorimit të kohës sipas ditëve të javës

Në seksionin e strukturës shqiptare të përdorimit të kohës më sipër, vlerat e mesatareve ishin për të gjitha ditët e javës. Në këtë seksion, bëhet një dallim midis ditëve të javës, d.m.th. nga e Hëna në të Premte dhe ditëve të fundjavës, d.m.th. të Shtunës dhe të Dielës.

Struktura e përdorimit të kohës në ditët e javës dhe në fundjavë ndryshon. Gjatë ditëve të fundjavës koha për punë të paguar dhe studime ulet, kurse koha e lirë dhe koha për aktivitete personale rritet, puna e papaguar mbetet relativisht e pandryshueshme.

Grafiku 3.3¹²: Koha mesatare e konsumuar për aktivitete sipas gjinisë, popullsia shqiptare e moshës 10 vjeç e sipër, ditëve të javës.



Grafiku 3.4¹³: Koha mesatare e shpenzuar për aktivitete sipas gjinisë, popullsia shqiptare e moshës 10 vjeç e sipër, ditëve të fundjavës.




Tabela 3.5: Përqindjet e popullsisë që kryejnë aktivitete¹⁴ sipas gjinisë, popullsia shqiptare e moshës 10 vjeç e sipër, ditëve të javës dhe fundjavës. Në orë

	Ditë jave			Ditë fundjave		
	Femra	Meshkuj	Të gjithë	Femra	Meshkuj	Të gjithë
	Përqindje (%)					
Punë e paguar	34	60	47	25	45	35
Studim	15	17	16	10	10	10
Punë e papaguar	91	39	65	92	43	68
Aktivitete personale	100	100	100	100	100	100
Kohë e lirë	97	99	98	97	99	98
Të tjera	6	4	5	12	8	10

Tabela 3.5 tregon se ajo pjesë e popullsisë që punon për të ardhura është më e vogël fundjavave sesa ditëve të javës. 60 përqind e meshkujve të popullsisë (këtu të moshës 10 vjeç e sipër) punojnë për të ardhura ditët e javës 45 përqind e bëjnë këtë fundjavave. Për Femrat, shifrat korresponduese janë 34 përqind përkundrejt 25 përqind. Ndërkohë që orientimi i këtyre ndryshimeve pritet, madhësia e tyre është më e vogël nga këndvështrimi evropian, siç shihet në seksionin 3.1 më sipër.


13 Ky grafik bazohet në shifrat e gjetura në Tabelën A.1 në shtojcën A ..

14 Shkalla e pjesëmarrjes

3.3 Struktura e përdorimit të kohës sipas moshës

3.3.1 Të gjitha ditët

Grafiku 3.5¹⁵: Koha mesatare e shpenzuar për aktivitete sipas gjinisë dhe moshës, popullsia shqiptare e moshës 10 vjeç e sipër, ditëve të javës.



Në Grafikon 3.5 struktura e përdorimit të kohës ndahet sipas grupmoshave. Dallohen tre grupe, një grup që dominohet nga nxënësit e shkollave (10-14 vjeç), një grup i madh që mbulon pjesën më të madhe të popullsisë ekonomikisht aktive (15-64 vjeç) dhe një grup të moshuarish (65 vjeç e sipër).

Me disa përjashtime, diferencat e gjetura midis burrave dhe grave në gjithë popullsinë (10 vjeç e lart) janë karakteristike edhe për grupmoshat, ndonëse në nivele të ndryshme. 10 përqind ose pak më pak se 10 për qind e vajzave dhe djemve të rinj (10 -14 vjeç) shpenzojnë njëfarë kohe për të bërë punë të paguar (Shih Tabelën 3.6 më poshtë), mesatarisht një çerek ore ose më pak kur shpërndahet në gjithë grupin. Pothuajse dy të tretat shpenzojnë një kohë të caktuar për të studiuar, mesatarisht rreth katër orë e gjysmë dhe nuk ka diferenca të konsiderueshme gjinore. Megjithatë, për kohën e lirë dhe punën e papaguar ka diferenca të konsiderueshme. Vajzat shpenzojnë afërsisht katër herë më shumë kohë për punë të papaguar sesa djemtë (një orë e gjysmë përkundrajt më pak se gjysmë ore). Edhe shkalla e pjesëmarrjes ndryshon; dy të tretat e vajzave bëjnë punë të papaguara gjatë një dite të zakonshme, ndërkohë që nga djemtë këtë e bëjnë më pak se një e treta. Sasia e kohës së lirë ndryshon me më shumë sesa një orë në favor të djemve.

Për dy grupmoshat e tjera ka diferenca gjinore të konsiderueshme në lidhje me punën e paguar dhe të papaguar, si dhe me kohën e lirë. Meshkujt shpenzojnë shumë më tepër kohë sesa femrat për punë të paguar dhe kohë të lirë, kurse femrat shpenzojnë shumë

më tepër kohë për punë të papaguar. Për grupmoshën 15-64, femrat shpenzojnë 7 herë më shumë kohë sesa Meshkujt për punë të papaguar (5:46 përkundrejt 0:48) një diferencë prej pesë orësh në ditë. Pothuajse çdo grua kryen punë të papaguar gjatë një dite të zakonshme të javës, kurse nga Meshkujt këtë e bëjnë vetëm diçka më pak se një e treta. Meshkujt në këtë grupmoshë shpenzojnë pak më shumë sesa dyfishi i kohës së shpenzojnë femrat për punë të paguar (5:13 përkundrejt 2:21). Pjesa e burrave që bëjnë punë të paguar është rreth sa dyfishi i grave (66 përqind përkundrejt 36 përqind). Si rrjedhojë, totali i punës së grave e kalon atë të burrave. Diferenca është rreth dy orë (8:07 përkundrejt 6:00) në ditë. Kjo diferencë ekuilibrohet kryesisht nga sasia e kohës së lirë, 3:47 për femrat dhe 5:14 për Meshkujt. Asnjë grup tjetër në Grafikun 3.5 nuk krahasohet me këtë grupmoshë grash sa i përket orëve të gjata të punës totale dhe kohës së lirë po aq të shkurtër.

Një pjesë e konsiderueshme e të moshuarve, 65 vjeç e sipër, shpenzon kohë në punë të paguar. 28 përqind e burrave dhe 16 përqind e grave angazhohen në punë të paguar gjatë një dite të zakonshme. Ndarja gjinore e punës dhe e kohës së lirë vazhdon të dominojë edhe me rritjen e njerëzve në moshë, ndonëse në nivel më të reduktuar. Meshkujt e moshuar kanë mesatarisht numrin më të vogël të totalit të orëve të punës dhe numrin më të madh të orëve të kohës së lirë.

Tabela 3.6: Përqindjet e popullsisë që kryejnë aktivitete sipas gjinisë dhe moshës, popullsia shqiptare e moshës 10 vjeç e sipër, ditëve të javës.

	10-14 vjeç			15-64 vjeç			65 vjeç +		
	Femra	Meshkuj	Të gjithë	Femra	Meshkuj	Të gjithë	Femra	Meshkuj	Të gjithë
	Përqindje (%)								
Punë e paguar	10	6	8	36	66	51	16	28	22
Studim	62	66	64	10	10	10	0	0	0
Punë e papaguar	67	30	48	95	38	67	86	63	75
Aktivitete personale	100	100	100	100	100	100	100	100	100
Kohë e lirë	100	100	100	96	98	97	99	100	100
Të tjera	7	3	5	6	5	6	14	13	14

3.3.2 Ditët e javës dhe ditët e fundjavës


Për të rinjtë, ditët e javës dhe ditët e fundjavës ndryshojnë ndjeshëm nga njëra-tjetra (shih Grafikët 3.6 dhe 3.7 më poshtë). Ata shpenzojnë shumë më pak kohë për të studiuar dhe më shumë kohë të lirë gjatë ditëve të fundjavës. Pjesa që shpenzon kohë për të studiuar gjatë ditëve të fundjavës është pothuajse gjysma. Ndryshe nga kjo, koha e lirë rritet ndjeshëm, ashtu sikurse edhe koha për aktivitete personale deri në njëfarë mase.

Për grupmoshën 15-65 vjeç, diferenca kryesore lidhet me punën e paguar. Kjo shpjegohet kryesisht me faktin se përqindjet e popullsisë që bëjnë punë të paguar ulet fundjavave me rreth 10 përqind për femrat dhe 20 përqind për Meshkujt, përkatësisht nga 40 përqind deri në 28 përqind dhe 72 përqind në 52 përqind (shih Tabelat 3.7 dhe 3.8 më poshtë). Si koha për aktivitete personale ashtu edhe koha e lirë rriten, të dyja


bashkë me dy orë. Pavarësisht nëse flitet për ditë jave apo për ditë fundjave, femrat e kësaj grupmoshe kanë pa diskutim numrin më të vogël të orëve të kohës së lirë dhe numrin më të madh të orëve të punës (d.m.th. punës në total).

Për të moshuarit, përdorimi i kohës në ditë jave dhe fundjave është pothuajse i njëjtë.

Grafiku 3.6¹⁶: Koha mesatare e shpenzuar për aktivitete sipas gjinisë dhe moshës, popullsia shqiptare e moshës 10 vjeç e sipër, ditëve të javës.



Grafiku 3.7¹⁷: Koha mesatare e shpenzuar për aktivitete sipas gjinisë dhe moshës, popullsia shqiptare e moshës 10 vjeç e sipër, ditëve të fundjavës.



16 Ky grafik bazohet në shifrat e gjetura në Tabelën A.3, A.5 dhe A.7 në shtojcën A.

17 Ky grafik bazohet në shifrat e gjetura në Tabelën A.3, A.5 dhe A.7 në shtojcën A.

Tabela 3.7: Përqindjet e popullsisë që kryejnë aktivitete sipas gjinisë dhe moshës, popullsia shqiptare e moshës 10 vjeç e sipër, ditëve të javës.

	10-14 vjeç			15-64 vjeç			65 vjeç +		
	Femra	Meshkuj	Të gjithë	Femra	Meshkuj	Të gjithë	Femra	Meshkuj	Të gjithë
	Përqindje (%)								
Punë e paguar	10	7	8	40	72	56	16	28	22
Studim	72	75	73	11	11	11	0	0	0
Punë e papaguar	64	28	45	95	37	66	87	64	87
Aktivitete personale	100	100	100	100	100	100	100	100	100
Kohë e lirë	100	100	100	96	98	97	100	100	100
Të tjera	4	2	3	5	4	4	13	13	13

Tabela 3.8: Përqindjet e popullsisë që kryejnë aktivitete sipas gjinisë dhe moshës, popullsia shqiptare e moshës 10 vjeç e sipër, ditëve të fundjavës.

	10-14 vjeç			15-64 vjeç			65 vjeç +		
	Femra	Meshkujt	Të gjithë	Femra	Meshkujt	Të gjithë	Femra	Meshkujt	Të gjithë
	Përqindje (%)								
Punë e paguar	10	4	7	28	52	40	16	28	21
Studim	39	43	41	8	7	8	0	0	0
Punë e papaguar	75	35	54	95	42	69	84	60	73
Aktivitete personale	100	100	100	100	100	100	100	100	100
Kohë e lirë	100	100	100	97	99	98	98	100	99
Të tjera	14	6	10	11	8	9	16	13	15

3.4 Struktura e përdorimit të kohës në zonat urbane dhe rurale

Siç duket edhe në Grafikon 3.8 (dhe Tabelën A.11 në shtojcën A), popullsia rurale (10 vjeç e sipër) shpenzon rreth gjysmë ore më shumë për punë të paguar dhe të papaguar, më pak kohë për studime dhe ka gjysmë ore më pak kohë të lirë. Koha për aktivitete personale është e njëjtë. Nga Tabela 3.9 më poshtë, përfundimi është se diferenca në punë të paguar shpjegohet me përqindjet më të vogla të grave dhe burrave në zonat urbane që punojnë në ditë mesatare, 25 përqind përkundrejt 39 përqind për femrat dhe 49 përqind përkundrejt 62 përqind për Meshkujt. E njëjta gjë vlen për studimet, ndonëse vetëm për femrat dhe në drejtimin e kundërt; një numër më i madh grash në zonat urbane studiojnë gjatë një dite të zakonshme, 18 përqind përkundrejt 9 përqind.

Diferencat gjinore janë të ndjeshme si në popullsinë urbane dhe rurale. Gratë rurale shpenzojnë pesë orë më shumë sesa Meshkujt ruralë për punë të papaguar. Për

popullsinë urbane, diferenca korresponduese është pak më pak se katër orë. Meshkujt urbanë dhe ruralë shpenzojnë të njëjtën sasi kohe për punë të papaguar, kurse për femrat ka një diferencë prej pothuajse një ore e gjysmë.

Grafiku 3.8¹⁸: Koha mesatare e shpenzuar për aktivitete sipas gjinisë dhe zonave urbane/rurale, popullsia shqiptare e moshës 10 vjeç e sipër, të gjitha ditët.




Tabela 3.9: Përqindjet e popullsisë që kryejnë aktivitete sipas gjinisë dhe zonës urbane ose rurale, popullsia shqiptare e moshës 10 vjeç e sipër, të gjitha ditët.

	Zona urbane			Zonë rurale		
	Femra	Meshkujt	Të gjithë	Femra	Meshkujt	Të gjithë
Përqindje (%)						
Punë e paguar	25	49	36	39	62	51
Studim	18	16	17	9	14	11
Punë e papaguar	89	41	67	94	39	65
Aktivitete personale	100	100	100	100	100	100
Kohë e lirë	97	99	98	96	99	98
Të tjera	9	5	7	6	6	6

Krahasimi i strukturës së përdorimit të kohës ditëve të javës dhe ditëve të fundjavës (shih Grafikun 3.9 dhe Tabelën 3.10, më poshtë) për popullsinë e zonave urbane dhe rurale nxjerr në pah disa diferenca (Grafiku 3.9). Femrat urbane në veçanti shpenzojnë më pak kohë për punë të paguar ditëve të fundjavës, diferenca është pak më e vogël se një orë e gjysmë. Për femrat rurale, diferenca është gjysmë ore më pak. Kjo përputhet me rënien e ndjeshme të numrit të grave urbane që kryejnë punë të paguar fundjavave. Duhet theksuar se një rënie e tillë nuk vihet re aspak tek femrat rurale, rreth 40 përqind punojnë ditët e javës dhe të fundjavës, që është njësoj me pjesën e burrave në zonat urbane ditëve të fundjavës. Raporti korrespondues është shumë më i lartë për Meshkujt

18 Ky grafik bazohet në shifrat e gjetura në Tabelën A.11 në shtojcën tabelë.

në zonat rurale pavarësisht ditës së javës. Po të fokusohemi tek diferenca në kohën e shpenzuar për ditë jave dhe fundjave, Meshkujt në zonat urbane dhe rurale janë më të ngjashëm sesa Femrat; diferenca e burrave midis ditëve të javës dhe fundjavës është pothuajse e njëjtë me atë për femrat urbane. Aktiviteti i studimit ulet, kurse puna e papaguar është pothuajse e njëjtë. Koha për aktivitete personale dhe koha e lirë rriten gjatë fundjavës. Grupi i vetëm për të cilin ndryshon më pak struktura e përdorimit të kohës midis ditëve të javës dhe ditëve të fundjavës është ajo e grave të zonave rurale. Pavarësisht ditës së javës, orët e tyre të punës (puna në total) janë më të gjata dhe orët e kohës së lirë më të shkurtra sesa për çdo grup tjetër.

Grafiku 3.9¹⁹: Koha mesatare e shpenzuar për aktivitete sipas gjinisë dhe zonës urbane/rurale, popullsia shqiptare e moshës 10 vjeç e sipër, ditëve të javës dhe fundjavës.




Tabela 3.10: Përqindjet e popullsisë që kryejnë aktivitete sipas gjinisë dhe zonës urbane ose rurale, popullsia shqiptare e moshës 10 vjeç e sipër, ditëve të javës dhe fundjavës.

	Femra				Meshkuj				Të gjithë			
	Urbane		Rurale		Urbane		Rurale		Urbanë		Ruralë	
	Ditë jave	Fundjavë	Ditë jave	Fundjavë	Ditë jave	Fundjavë	Ditë jave	Fundjavë	Ditë jave	Fundjavë	Ditë jave	Fundjavë
Punë e paguar	29	13	40	39	54	38	66	51	41	24	54	45
Studim	19	14	10	6	18	10	15	10	19	12	13	8
Punë e papaguar	88	90	93	94	41	43	38	43	66	68	64	67
Aktivitete personale	100	100	100	100	100	100	100	100	100	100	100	100
Kohë e lirë	97	99	96	96	98	99	99	99	98	99	98	98
Të tjera	7	14	4	9	4	9	5	7	5	12	5	8

19 Ky grafik bazohet në shifrat e gjetura në Tabelën A.16 dhe A.21 në shtojcën A.

3.5 Struktura e përdorimit të kohës sipas të pasurit ose jo fëmijë

Grafiku 3.10²⁰: Koha mesatare e shpenzuar për aktivitete sipas gjinisë dhe të pasurit ose jo fëmijë, popullsia shqiptare e moshës 15 vjeç e sipër, të gjitha ditët.




Tabela 3.11: Përqindjet e popullsisë që kryejnë aktivitete sipas gjinisë dhe të pasurit të fëmijëve, popullsia shqiptare e moshës 15 vjeç e sipër, të gjitha ditët.

	Me partner dhe fëmijë nën 7 vjeç			Me partner dhe fëmijë 7- 16 vjeç			Me partner dhe pa fëmijë nën 17			Pa partner dhe pa fëmijë nën 17		
	F	M	Të gjithë	F	M	Të gjithë	F	M	Të gjithë	F	M	Të gjithë
Punë e paguar	32	85	58	51	83	66	37	59	48	22	44	33
Studim	1	0	1	1	0	1	2	0	1	22	22	22
Punë e papaguar	99	49	75	99	40	71	97	49	73	86	33	58
Aktivitete personale	100	100	100	100	100	100	100	100	100	100	100	100
Koha e lirë	94	98	96	94	98	96	97	98	98	98	99	99
Të tjera	7	6	6	8	4	6	9	8	9	7	5	6

Në Tabelën 3.11 dhe Grafikun 3.10 fëmijët janë ndarë në dy grupmosha. Në një grup, fëmija më i vogël në moshë në familje është 6 vjeç ose më pak, kurse në tjetrin midis 7 dhe 16 vjeç. Të gjithë prindërit me fëmijë jetojnë bashkë. Numri i prindërve që jetojnë pa një partner është tepër i vogël për të formuar një grup më vete. Shumë të rinj mesa duket janë përfshirë në grupin pa fëmijë dhe pa partner, pasi studimi është një aktivitet relativisht i përbashkët. Pjesa më e madhe e të moshuarve supozohet të jenë përfshirë në njërin prej dy grupeve pa fëmijë. Për këtë arsye, të dy grupet pa fëmijë mund të jenë më heterogjene sa i përket moshës sesa grupeve që kanë fëmijë.

Grafiku 3.10 tregon qartë se të pasurit e fëmijëve ka pasoja të dallueshme tek përdorimi i kohës nga gratë. Krahësuar me gratë që kanë vetëm fëmijë më të rritur, d.m.th. midis moshës 7 dhe 16 vjeç, ato shpenzojnë edhe një orë ose më shumë për punë të papaguar, kryesisht duke u kujdesur për fëmijët, kohë që do të tregohet në Seksionin 5.1. ato kanë më pak kohë të lirë dhe kohë për aktivitete personale. Ajo çka kryesisht ekuilibron punën e papaguar shtesë është koha më e vogël për punë të paguar. Diferenca në punë të paguar ka të bëjë kryesisht me pjesën që punon ditëve të zakonshme, që është rreth 50 përqind përkundrajt 30 përqind. Diferenca në numrin e orëve të punës është e vogël, rreth 40 minuta në një ditë pune prej më shumë se 6 orësh.

Struktura e përdorimit të kohës është pothuajse identike për Meshkujt, pavarësisht moshës së fëmijës më të vogël. Krahësuar me Femrat, koha e tyre për punë në total është rreth dy orë më pak. Ata kanë edhe një çerek ore më shumë kohë të lirë dhe një tjetër orë më shumë për aktivitete personale.

3.6 Struktura e përdorimit të kohës sipas statusit të punësimit

Të intervistuarit janë klasifikuar në dy grupe mbi bazën e përkufizimeve të Organizatës Ndërkombëtare të Punës. Në kategorinë *në punësim* futen të gjithë të punësuarit qofshin të punësuar me pagë apo të vetë-punësuar. Ata që janë klasifikuar në kategorinë *jo në punësim* ose janë të papunë ose janë persona ekonomikisht joaktivë.

Megjithëse jo në punësim, rreth 20 përqind e burrave dhe 10 përqind e grave kalojnë një kohë të caktuar duke bërë punë të paguar gjatë një dite të zakonshme të javës. Përqindjet e marra nga të intervistuarit në punësim janë shumë më të larta, 80 përqind për femrat dhe 87 përqind për Meshkujt. Gjatësia e ditës së punës për njerëzit e punësuar është pak më e madhe sesa dyfishi i atyre të grupit tjetër (jo në punësim), për femrat shtatë përkundrajt tre orëve, kurse për Meshkujt pak më shumë sesa tetë përkundrajt katër orësh.

Ka luhatje të mëdha në strukturën e përdorimit të kohës midis grupeve, jo vetëm sa i takon punës së paguar. Diferencat gjinore të para në seksionet e mëparshme janë pothuajse po aq të mëdha edhe këtu; puna totale e grave është më e madhe se e burrave, kurse koha e lirë e burrave është më e madhe se e grave. Femrat e punësuar duket se sforcohen jashtëzakonisht; ato kanë ditën më të gjatë të punës (d.m.th. punës në total) nga dy deri në tetë orë, kohën e lirë më të shkurtër nga një orë deri në pothuajse katër orë, si dhe kohën më të shkurtër për aktivitete personale, ku diferenca është nga një deri në dy orë.

Kur ulet koha për punë të paguar, për shkak të daljes në pension, papunësisë apo për çfarëdolloj arsyeje tjetër, mbetet më shumë kohë për aktivitetet e tjera. Për Meshkujt duket qartë se kjo kohë që u mbetet kur ulet koha e punës së paguar, ka shumë më tepër gjasa që të shkojë për aktivitete në kohën e lirë sesa për punë të papaguar. Femrat e ndajnë në mënyrë më të barabartë kohën që u mbetet mes punës së papaguar dhe aktiviteteve në kohën e lirë.

Grafiku 3.11²¹. Koha mesatare e shpenzuar për aktivitete sipas gjinisë dhe statusit të punësimit, popullsia shqiptare e moshës 15 vjeç e sipër, të gjitha ditët.




Tabela 3.12: Përqindjet e popullsisë që kryejnë aktivitete sipas gjinisë dhe statusit të punësimit, popullsia shqiptare e moshës 15 vjeç e sipër, të gjitha ditët, në përqindje

	Të punësuar			Të papunësuar		
	Femra	Meshkuj	Të gjithë	Femra	Meshkuj	Të gjithë
Punë e paguar	80	87	85	9	21	13
Studim	1	1	1	13	22	16
Punë e papaguar	94	37	58	93	48	77
Aktivitete personale	100	100	100	100	100	100
Kohë e lirë	94	98	97	98	99	98
Të tjera	6	5	6	8	7	8

4

PËRDORIMI I KOHËS, I SHPJEGUAR NË MËNYRË MË TË DETAJUAR

Seksionet në vijim paraqesin në mënyrë më të detajuar dy kategoritë e aktiviteteve, përkatësisht punën e papaguar dhe kohën e lirë. Sistemi i koduar i aktivitetit HETUS është hierarkik dhe i ndarë në tre nivele, një nivel një shifror, një nivel dy-shifror dhe një tre-shifror (shihni Shtojcën C). Aktivitetet janë koduar në nivelin tre shifror. Paragrafët e mësipërm për strukturën e përdorimit të kohës përdorin aktivitete të agreguara dhe të modifikuara të nivelit një shifror. Duhet përmendur se sistemi i koduar i aktivitetit i paraqitur në shtojcën xx nuk është domosdoshmërisht normativ; ai përfaqëson një prej mënyrave të pafundme të agregimit të aktiviteteve të nivelit tre shifror. Objektivat e studimit ndikojnë procesin e agregimit, siç ndikon edhe madhësia e kampionëve dhe shpeshtësia e aktiviteteve.

Në këtë pjesë përdoret niveli dy shifror. Tabelat përmbajnë vlerësime të ndara për Meshkujt dhe Femrat, për tre grupmosha të ndryshme si dhe për zonat urbane dhe rurale, për moshën e fëmijës më të vogël dhe për statusin e punësimit. Tregohet gjithashtu edhe koha e aktiviteteve dhe norma e pjesëmarrjes.

4.1 Puna e papaguar

Në këtë pjesë puna e papaguar ndahet në nëntë grupe aktivitetshe të nivelit dy shifror.

4.1.1 Mosha dhe gjinia

Tabela 4.1: Koha mesatare e shpenzuar për aktivitete shtëpiake, sipas gjinisë dhe moshës, popullsi shqiptare e moshës 10 vjeç e sipër, të gjitha ditët

	Moshë										
	10+			10-14			15-65			65+	
	Femra	Meshkuj	Të gjithë	Femra	Meshkujt	Femra	Meshkuj	Të gjithë	Femra	Meshkuj	Të gjithë
Përgatitja e ushqimit, larja e enëve	02:07	00:05	01:06	00:27	00:02	00:14	02:20	00:04	01:12	00:15	01:09
Pastrimi dhe punët e tjera	01:12	00:06	00:40	00:29	00:06	00:17	01:20	00:06	00:43	00:10	00:34
Larja e rrobave, hekurosja, punët e dorës dhe tekstilet	00:33	00:00	00:17	00:04	00:00	00:02	00:37	00:00	00:19	00:01	00:16
Kopshtaria, punë ndërtimi dhe riparime	00:13	00:14	00:13	00:02	00:04	00:03	00:13	00:13	00:13	00:29	00:24
Pazari dhe shërbimet	00:09	00:06	00:08	00:02	00:03	00:02	00:10	00:06	00:08	00:17	00:13
Kujdesi për fëmijët	00:39	00:04	00:22	00:05	00:01	00:03	00:47	00:05	00:26	00:03	00:10
Kujdesi për të rriturit	00:04	00:01	00:02	00:09	00:01	00:05	00:03	00:01	00:02	00:02	00:03
Administrimi i shtëpisë	00:00	00:00	00:00	00:00	00:00	00:00	00:00	00:00	00:00	00:00	00:00
Udhëtime për punë të papaguar	00:12	00:10	00:11	00:05	00:03	00:04	00:13	00:10	00:11	00:13	00:12
Totali i punës së papaguar	05:13	00:50	03:02	01:27	00:23	00:53	05:46	00:48	03:18	01:34	03:05

Tabela 4.2: Përqindjet e popullsisë që kryejnë aktivitete shtrëpiake sipas gjinisë dhe moshës, popullsi shqiptare e moshës 10 vjeç e sipër, të gjitha ditët

	Moshë										
	10+			10-14			15-64			65+	
	Femra	Meshkuj	Të gjithë	Femra	Meshkuj	Të gjithë	Femra	Meshkuj	Të gjithë	Femra	Meshkuj
Përgatitja e ushqimit, larja e enëve	82	10	46	39	6	22	88	9	49	79	19
Pastrimi dhe punët e tjera	72	12	42	43	16	29	77	10	44	63	19
Larja e rrobave, hekurosja, punët e dorës dhe tekstilet	41	1	21	8	1	4	47	1	24	33	2
Kopshtaria, punë ndërtimi dhe riparime	10	11	11	4	7	5	10	10	10	18	21
Pazarë dhe shërbimet	26	14	20	13	10	11	27	12	20	28	33
Kujdesi për fëmijët	28	7	17	7	2	4	32	8	20	12	5
Kujdesi për të rriturit	8	2	5	9	2	5	8	1	5	5	5
Administrimi i shtëpisë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Udhëtime për punë të papaguar	29	19	24	13	12	13	31	17	24	30	39
Totali i punës së papaguar	91	40	66	67	30	48	95	38	67	86	63
											75

Puna e papaguar lidhet me pabarazinë e lartë gjinore në Shqipëri. Në seksionin 3 është treguar se koha totale që Meshkujt i kushtojnë punës së papaguar, sipas popullsisë 10 vjeç e sipër, është 14 përqind. Pjesa që femrat i kushtojnë është 86 përqind. Tabela 4.1 tregon se shpërndarja e disa punëve të tjera të shtëpisë është edhe më asimetrike. Për aktivitete të tjera është më pak asimetrike. Koha e shpenzuar nga femrat (10 vjeç e sipër) për punët kryesore të shtëpisë si gatimi, larja e enëve, pastrimi dhe mirëmbajtja e shtëpisë, larja e rrobave dhe hekurosja, është afërsisht katër orë në ditë. Meshkujt shpenzojnë rreth dhjetë minuta për këto aktivitete. Nëse e kufizojmë krahasimin në grupmoshën e personave që janë aktiv ekonomikisht, d.m.th 15-64 vjeç, shpërndarja bëhet edhe më asimetrike. Femrat shpenzojnë katër orë e një çerek, Meshkujt dhjetë minuta – kjo do të thotë se koha e shpenzuar nga femrat në aktivitetet shtëpiake e tejkalon 95 përqindshin. Në dy grupmoshat e tjera, diferencat përkatëse mbeten të mëdha, por përsëri nuk arrijnë të njëjtat nivele.

Koha kushtuar kujdesit për fëmijët si aktivitet kryesor (shtjelluar më tej në Seksionin 5.1) ndryshon dukshëm. E shpërndarë në të gjithë grupmoshën 15-65 vjeç – njerëz me ose pa fëmijë – diferenca është rreth 40 minuta, 47 minuta kundrejt 5 minutave. Aktiviteti i shpërndarë në mënyrë më të barabartë është kopshtaria – si femrat edhe Meshkujt shpenzojnë rreth një çerek ore për këtë aktivitet. Pazari dhe shërbimet nuk marrin shumë kohë, rreth gjysmë ore ose më pak, kryesisht i kryer nga Femrat. Koha e shpenzuar për udhëtime për punë të papaguar është rreth 10 minuta për të dyja gjinitë. Një pjesë e mirë e kësaj kohe lidhet me kryerjen e pazarit. Koha e kujdesit për të rriturit është e paktë. Ka arsye të besohet se aktiviteti kryesor në ditë nuk përfshin këtë lloj aktiviteti sepse një pjesë e mirë e kujdesit për të rriturit fshihet pas etiketave të punëve të tjera si për shembull gatimi. Aktiviteti i rëndësishëm i kujdesit për fëmijët lidhet me të njëjtën dilemë (shihni Seksionin 5.1).

4.1.2 Zonat urbane dhe rurale

Tabela 4.3: Koha mesatare e shpenzuar për aktivitetet shtëpiake sipas gjinisë dhe zonës urbane/rurale, popullsi shqiptare e moshës 10 vjeç e sipër, të gjitha ditët

	Urbane			Rurale		
	Femra	Meshkuj	Të gjithë	Femra	Meshkuj	Të gjithë
Përgatitja e ushqimit, larja e enëve	01:54	00:06	01:04	02:24	00:04	01:10
Pastrimi dhe punët e tjera	01:00	00:03	00:34	01:23	00:09	00:44
Larja e rrobave, hekurosja, punët e dorës dhe tekstilet	00:27	00:00	00:14	00:41	00:00	00:19
Kopshtaria, punë ndërtimi dhe riparime	00:03	00:05	00:04	00:25	00:19	00:22
Pazari dhe shërbimet	00:13	00:08	00:10	00:04	00:03	00:03
Kujdesi për fëmijët	00:36	00:05	00:22	00:45	00:05	00:24
Kujdesi për të rriturit	00:03	00:01	00:02	00:04	00:01	00:03
Administrimi i shtëpisë	00:00	00:00	00:00	00:00	00:00	00:00
Udhëtime për punë të papaguar	00:16	00:09	00:13	00:08	00:09	00:08
Totali i punës së papaguar	04:35	00:41	02:46	05:57	00:53	03:16

Tabela 4.4: Përqindjet e popullsisë që kryejnë aktivitete shtëpiake sipas gjinisë dhe zonës urbane/rurale, popullsi shqiptare e moshës 10 vjeç e sipër, të gjitha ditët

	Urbane			Rurale		
	Femra	Meshkuj	Të gjithë	Femra	Meshkuj	Të gjithë
Përgatitja e ushqimit, larja e enëve	78	13	48	87	8	45
Pastrimi dhe punët e tjera	65	8	39	77	14	44
Larja e rrobave, hekurosja, punët e dorës dhe tekstilet	37	1	20	47	1	23
Kopshtaria, punë ndërtimi dhe riparime	4	7	5	19	13	16
Pazari dhe shërbimet	38	17	28	14	8	11
Kujdesi për fëmijët	26	7	18	30	7	18
Kujdesi për të rriturit	7	2	5	9	2	5
Administrimi i shtëpisë	0	0	0	0	0	0
Udhëtime për punë të papaguar	40	21	31	19	14	16
Totali i punës së papaguar	88	41	66	93	38	64

Në Seksionin 4.1.1 vihet re se ka një ndryshim të madh gjinie në lidhje me aktivitetet e përfshira në kategorinë 'punë e papaguar'. Tabela 4.3 tregon se kjo është veçanërisht e vërtetë si për zonat urbane dhe ato rurale. Por ka edhe diferenca të tjera. Femrat

rurale kalojnë më shumë kohë se femrat urbane për gatim, pastrim dhe larje rrobash. Diferenca për të tre aktivitetet së bashku është rreth një orë, 3:21 për femrat urbane dhe 4:28 për ato rurale. Një diferencë e madhe ekziston edhe në lidhje me kopshtarinë. Siç pritet, si femrat edhe Meshkujt rural kalojnë më shumë kohë me kopshtari. Ndërsa kryerja e pazarit duket se është organizuar ndryshe. Rezultatet në tabelat 4.3 dhe 4.4 tregojnë se pazari është aktivitet më i shpeshtë në zonat urbane se ato rurale, çfarë edhe pritej. Në total, femrat urbane shpenzojnë më shumë se një orë shtesë punë të papaguar. Meshkujt urban dhe ata rural ndryshojnë vetëm në mënyrë marxhinale.

4.1.3 Të pasurit e fëmijëve

Seksioni 3.5 tregon sesi struktura e kohës varet nga mosha e fëmijës më të vogël. Në tabelat 4.5 dhe 4.6 në vijim duket qartë se diferenca kryesore midis femrave që kanë fëmijë të vegjël apo vetëm fëmijë të rritur ka lidhje me kohën kushtuar kujdesit të fëmijëve, e cila është 2.5 orë kundrejt gjysmë ore. Mund të ketë edhe ndryshim të vogël në kohën e shpenzuar për larjen e rrobave, si në sasinë e minutave edhe në proporcionin kohor të shpenzuar për këtë aktivitet gjatë një dite mesatare. Diferenca totale për punën e papaguar është pak më shumë se dy orë. Sasia dhe përmbajtja e punës së papaguar që kryhet nga femrat me fëmijë 7 deri në 16 vjeç dhe femrat që nuk kanë fëmijë më të vegjël se 17 vjeç, por që të dyja me partner, është shumë e ngjashme. Femrat pa partner dhe pa fëmijë ndryshojnë. Ato janë kryesisht të reja dhe i kushtojnë më pak kohë punës së papaguar në total, por kalojnë po aq kohë për larje rrobash sa femrat e tjera në grup. Siç është përmendur, Meshkujt shpenzojnë një kohë të kufizuar për punën e papaguar. Meshkujt me partner dhe me fëmijë në dy grupmoshat më sipër ndryshojnë shumë pak. Mund të ketë një ndryshim të vogël në kohën kushtuar kujdesit për fëmijët, por në nivel të ultë. Një në katër meshkuj me fëmijë 0-6 vjeç, kanë shënuar në ditarin e tyre se shpenzojnë të paktën pak kohë duke u kujdesur për ta. Mesatarja totale është rreth 10 minuta, që do të thotë më shumë se dy orë më pak se koha e shpenzuar nga Femrat, d.m.th Meshkujt shpenzojnë rreth 10 përqind të kohës së tyre totale duke u kujdesur për fëmijët e vegjël. Duhet përmendur se kujdesi për fëmijët në këtë kontekst i referohet atyre aktiviteteve të shënuara në ditar, që përcaktohen specifikisht si kujdes për fëmijët, si për shembull «kam lozur me vajzën». Ka shumë situata ku ndodh një lloj kujdesi për fëmijë, si për shembull ngrënia e një vakti së bashku. Çështja do të trajtohet më tepër në Seksionin 5.1.

Tabela 4.5: Koha mesatare e shpenzuar për aktivitetet shtëpiake sipas gjinisë dhe pasjes së fëmijëve, popullsi shqiptare e moshës 15 vjeç e sipër, të gjitha ditët. Orët dhe minutat

	Me partner dhe fëmijë nën 7 vjeç			Me partner dhe fëmijë 7- 16 vjeç			Me partner por pa fëmijë nën 17 vjeç			Pa partner dhe pa fëmijë nën 17 vjeç		
	Femra	Meshkuj	Të gjithë	Femra	Meshkuj	Të gjithë	Femra	Meshkuj	Të gjithë	Femra	Meshkuj	Total
Përgatitja e ushqimit, larja e enëve	02:49	00:02	01:28	02:50	00:01	01:29	02:44	00:06	01:26	01:27	00:07	00:46
Pastrimi dhe punët e tjera	01:32	00:04	00:49	01:28	00:02	00:47	01:25	00:08	00:46	00:58	00:08	00:32
Larja e rrobave, hekurosja, punët e dorës dhe tekstilet	00:50	00:00	00:25	00:35	00:00	00:18	00:35	00:00	00:18	00:31	00:00	00:15
Kopshtaria, punë ndërtimi dhe riparime	00:09	00:08	00:08	00:16	00:14	00:15	00:26	00:29	00:28	00:07	00:08	00:08
Pazari dhe shërbimet	00:08	00:06	00:07	00:12	00:06	00:09	00:12	00:10	00:11	00:08	00:05	00:07
Kujdesi për fëmijët	02:29	00:19	01:25	00:35	00:05	00:21	00:23	00:04	00:14	00:09	00:00	00:04
Kujdesi për të rriturit	00:07	00:00	00:03	00:05	00:00	00:02	00:02	00:02	00:02	00:02	00:02	00:02
Punë tjetër e papaguar	00:00	00:00	00:00	00:00	00:00	00:00	00:00	00:00	00:00	00:00	00:00	00:00
Udhëtime për punë të papaguar	00:18	00:17	00:17	00:13	00:13	00:13	00:13	00:11	00:12	00:09	00:06	00:08
Totali i punës së papaguar	08:26	00:58	04:47	06:16	00:45	03:38	06:05	01:13	03:40	03:34	00:40	02:04

Tabela 4.6: Përqindjet e popullsisë që kryejnë aktivitetet shtëpiake sipas gjinisë dhe fëmijëve, popullsi shqiptare 15 vjeç e sipër, ditë jave. Përqindja

	Me partner dhe fëmijë nën 7 vjeç				Me partner dhe fëmijë 7- 16 vjeç				Me partner por pa fëmijë nën 17 vjeç				Pa partner dhe pa fëmijë nën 17 vjeç			
	Femra	Meshkuj	Të gjithë		Femra	Meshkuj	Të gjithë		Femra	Meshkuj	Të gjithë		Femra	Meshkuj	Të gjithë	
Përgatitja e ushqimit, larja e enëve	97	8	54		96	6	53		91	10	51		74	12	42	
Pastrimi dhe punët e tjera	86	8	48		85	7	48		80	13	46		60	13	36	
Larja e rrobave, hekurosja, punët e dorës dhe tekstilet	63	1	33		46	0	24		47	1	24		34	2	18	
Kopshtaria, punë ndërtimi dhe riparime	9	10	9		11	11	11		19	19	19		6	7	6	
Pazari dhe shërbimet	29	15	22		28	15	22		32	21	27		22	9	15	
Kujdesi për fëmijët	87	27	58		37	8	24		15	4	10		8	1	4	
Kujdesi për të rriturit	16	1	9		10	0	6		5	3	4		4	2	3	
Administrimi i shtëpisë	0	0	0		0	0	0		0	0	0		0	0	0	
Udhëtime për punë të papaguar	38	20	30		32	20	26		34	26	30		23	14	19	
Totali i punës së papaguar	99	49	75		99	40	71		97	49	73		86	33	58	

4.1.4 Statusi i punësimit

Të qenit i punësuar lidhet me faktin se shpenzohet më pak kohë për punë të papaguar në krahasim me të qenit jo në punësim. Për femrat diferenca është një orë e gjysmë, ndërsa për Meshkujt gjysmë ore. Personat jo në punësim shpenzojnë pak më shumë, ose aspak më shumë, kohë për aktivitetet e papaguara të shtëpisë. Të dy grupet ndryshojnë nga mosha. Në grupin e personave jo në punësim përfshihen të rinj e të moshuar – studentë e pensionistë, që do të thotë një sjellje heterogjene dhe si rrjedhojë një përdorim heterogjen i kohës. Rezultatet janë të vështira për t'u interpretuar, megjithatë tregonin edhe një herë se përdorimi i kohës nga Meshkujt në krahasim me gratë, veçanërisht koha e përdorur për punë të papaguar, është shumë më pak e ndikuar nga rrethanat e tilla si puna apo fëmijët.

Tabela 4.7: Koha mesatare e shpenzuar për aktivitetet shtëpiake sipas gjinisë dhe statusit të punësimit, popullsia shqiptare e moshës 15 vjeç e sipër, të gjitha ditët

	Në punësim			Jo në punësim		
	Femra	Meshkuj	Të gjithë	Femra	Meshkuj	Të gjithë
Përgatitja e ushqimit, larja e enëve	02:07	00:03	00:49	02:22	00:07	01:33
Pastrimi dhe punët e tjera	01:04	00:05	00:27	01:24	00:09	00:56
Larja e rrobave, hekurosja, punët e dorës dhe tekstilet	00:28	00:00	00:10	00:41	00:00	00:26
Kopshtaria, punë ndërtimi dhe riparime	00:11	00:10	00:11	00:15	00:22	00:18
Pazari dhe shërbimet	00:07	00:05	00:06	00:11	00:10	00:11
Kujdesi për fëmijët	00:27	00:06	00:13	00:51	00:04	00:34
Kujdesi për të rriturit	00:01	00:00	00:01	00:04	00:02	00:04
Punë tjetër e papaguar	00:00	00:00	00:00	00:00	00:00	00:00
Udhëtime për punë të papaguar	00:09	00:08	00:08	00:14	00:15	00:15
Totali i punës së papaguar	04:38	00:41	02:09	06:08	01:13	04:20

Tabela 4.8: Përqindja e popullsisë që kryejnë aktivitete shtëpiake sipas gjinisë dhe statusit të punësimit, popullsi shqiptare 15 vjeç e sipër, ditë jave

	Në punësim			Jo në punësim		
	Femra	Meshkuj	Të gjithë	Femra	Meshkuj	Të gjithë
Përgatitja e ushqimit, larja e enëve	90	9	39	85	12	58
Pastrimi dhe punët e tjera	72	9	33	76	15	54
Larja e rrobave, hekurosja, punët e dorës dhe tekstilet	42	2	17	46	1	30
Kopshtaria, punë ndërtimi dhe riparime	9	10	9	12	14	13
Pazari dhe shërbimet	21	11	15	31	19	26
Kujdesi për fëmijët	26	9	15	32	5	22
Kujdesi për të rriturit	5	1	3	9	3	7
Administrimi i shtëpisë	0	0	0	0	0	0
Udhëtime për punë të papaguar	24	14	18	34	28	32
Totali i punës së papaguar	94	37	58	93	48	77

4.2 Koha e lirë

Aktivitetet e kohës së lirë janë agreguar sipas të njëjtave parime si për punën e papaguar më sipër, d.m.th përdoret niveli dy shifror. Përmbajtja e kategorive të aktiviteteve gjendet në Shtojcën C. Janë paraqitur të njëjtat vlerësime si në seksionin paraprës.

4.2.1 Moshë dhe gjinia

Tabela 4.9: Koha mesatare e shpenzuar për aktivitete të kohës së lirë sipas gjinisë dhe moshës, popullsi shqiptare e moshës 10 vjeç e sipër, të gjitha ditët

Moshë											
	10+		10-14		15-64		65 +				
	Femra	Meshkuj	Të gjithë	Femra	Meshkuj	Të gjithë	Femra	Meshkuj	Të gjithë	Meshkuj	Të gjithë
TV dhe video	01:37	02:02	01:49	02:20	02:20	02:20	01:30	01:54	01:42	02:43	02:16
Shoqërimi	00:40	00:39	00:39	00:28	00:18	00:23	00:38	00:39	00:38	01:02	01:03
Leximi	00:07	00:07	00:07	00:16	00:10	00:13	00:07	00:05	00:06	00:15	00:09
Hobi dhe lojëra	00:05	00:19	00:12	00:44	01:07	00:56	00:01	00:13	00:07	00:11	00:05
Sport	00:08	00:25	00:17	00:11	00:48	00:30	00:08	00:21	00:15	00:32	00:20
Punë vullnetare dhe ndihmë	00:01	00:02	00:02	00:00	00:03	00:01	00:01	00:02	00:01	00:05	00:04
Kompiuter	00:06	00:13	00:09	00:06	00:15	00:11	00:06	00:14	00:10	00:02	00:01
Argëtim	00:00	00:01	00:00	00:00	00:00	00:00	00:00	00:01	00:00	00:00	00:00
Pushim	00:59	01:02	01:00	00:43	00:48	00:46	00:51	00:57	00:54	01:47	01:58
Aktivitetet tjera të kohës së lirë	00:02	00:01	00:01	00:05	00:02	00:03	00:01	00:01	00:01	00:02	00:02
Udhëtim për kohën e lirë	00:18	00:41	00:29	00:19	00:35	00:27	00:18	00:43	00:30	00:34	00:25
Totali i kohës së lirë	04:08	05:35	04:52	05:16	06:30	05:55	03:47	05:14	04:30	07:19	06:27

Tabela 4.10: Përqindjet e popullsisë që kryejnë aktivitete të kohës së lirë sipas gjinisë dhe moshës, popullsi shqiptare 10 vjeç e sipër, ditë jave

Moshë												
	10+			10-14			15-64			65+		
	Femra	Meshkuj	Të gjithë	Femra	Meshkuj	Të gjithë	Femra	Meshkuj	Të gjithë	Femra	Meshkuj	Të gjithë
TV dhe video	76	81	78	87	88	88	75	80	77	74	85	79
Shoqërimi	48	43	46	35	31	33	48	43	45	57	57	57
Leximi	9	9	9	18	13	15	9	8	8	4	18	11
Hobi dhe lojëra	5	16	11	37	51	44	2	13	7	1	12	6
Sport	10	21	15	12	39	26	9	19	14	10	23	16
Punë vullnetare dhe ndihmë	2	2	2	0	3	2	2	1	2	4	6	5
Kompjuter	7	11	9	8	17	13	7	12	9	1	2	1
Argëtim	0	1	1	0	0	0	0	1	1	0	0	0
Pushim	54	59	57	45	51	48	52	59	55	75	71	73
Aktivitetet tjera të kohës së lirë	4	2	3	9	3	6	3	2	3	3	3	3
Udhëtim për kohën e lirë	36	66	51	38	71	55	35	66	50	38	61	49
Totali i kohës së lirë	97	99	98	100	100	100	96	98	97	99	100	100

Si për gratë dhe për Meshkujt, të rinj e të moshuar, koha e lirë dominohet nga të parit televizor. Një e treta deri në 40 përqind e kohës së lirë i kushtohet televizorit. Për sa i përket numrit të orëve, ato variojnë nga pak më shumë se një orë e gjysmë për vajzat e reja deri në dy orë e treçerek për Meshkujt e moshuar. Të paktën tre në katër persona shohin televizor gjatë një dite të zakonshme. Të rinjtë dhe të moshuarit i kushtojnë më shumë kohë televizorit se moshë mesatare, me përjashtim të grupmoshës më të re; Meshkujt shohin më shumë televizor se gratë. Një tjetër 'aktivitet' që zë një pjesë të madhe të kohës së lirë është pushimi - mesatarisht 45 minuta për të rinjtë, pak më shumë për grupmoshën 15-64 vjeç dhe rreth dy orë për të moshuarit. Një aktivitet i tretë i rëndësishëm për të rinjtë janë hobi dhe lojërat, të cilave u kushtojnë mesatarisht një orë, edhe pse 20 minuta më tepër nga djemtë se nga vajzat. Pjesa "Hobi dhe lojëra" e kohës totale të lirë mbetet në fakt e njëjtë sepse djemtë kanë pak më shumë se një orë më tepër kohë të lirë se vajzat. Për grupmoshën 15 vjeçare vend të rëndësishëm zë shoqërimi. Grupmosha 15-64 vjeç kalon 40 minuta për shoqërim, ndërsa të moshuarit një orë. Nuk ka diferenca gjinore.

Janë dy aktivitete të kohës së lirë që kanë ndryshime të dukshme gjinore - sporti dhe udhëtimi për kohën e lirë. Në të dyja rastet, Meshkujt shpenzojnë më shumë kohë se gratë. Numri i meshkujve të përfshirë në këto aktivitete është gjithashtu më i lartë.

Koha e kaluar në kompjuter mund të mos jetë e saktë sepse kompjuteri përdoret për të kryer aktivitete të shumta sesa si aktivitet më vete. Udhëzimet HETUS e trajtojnë përdorimin e kompjuterit si një mjet të pavarur regjistrimi në ditar - që do të thotë se nëse një kompjuter është përdorur në lidhje me një aktivitet të raportuar, duhet shënuar në ditar dhe të regjistrohet në bazën e të dhënave. Kjo metodë nuk u aplikua plotësisht në studimin për Shqipërinë. Ekziston një problem edhe me kategorinë 'punë vullnetare dhe ndihmë', sepse shumë aktivitete të tjera mund të jenë, praktikisht, punë vullnetare ose ndihmë. Për shembull, gatimi për të ndihmuar dikë nuk shënohet dhe kodohet domosdoshmërisht në kategorinë e aktiviteteve ndihmëse, por mund të shënohet në kategorinë gatim.

4.2.2 Zonat urbane dhe rurale

Tabela 4.11: Koha mesatare e shpenzuar për aktivitete të kohës së lirë sipas gjinisë dhe zonës urbane/rurale, popullsi shqiptare e moshës 10 vjeç e sipër, të gjitha ditët

	Urbane			Rurale		
	Femra	Meshkuj	Të gjithë	Femra	Meshkuj	Të gjithë
TV dhe video	01:49	02:02	01:55	01:24	02:02	01:44
Shoqërizimi	00:42	00:40	00:41	00:38	00:38	00:38
Leximi	00:09	00:10	00:09	00:05	00:04	00:05
Hobi dhe lojëra	00:06	00:18	00:11	00:04	00:20	00:12
Sport	00:13	00:38	00:25	00:03	00:14	00:09
Punë vullnetare dhe ndihmë	00:01	00:02	00:02	00:01	00:02	00:02
Kompjuter	00:10	00:18	00:14	00:01	00:08	00:04
Argëtim	00:00	00:02	00:01	00:00	00:00	00:00
Pushim	00:52	00:52	00:52	01:07	01:10	01:09
Aktivitete të tjera të kohës së lirë	00:02	00:02	00:02	00:01	00:01	00:01
Udhëtim për kohën e lirë	00:25	00:47	00:35	00:11	00:36	00:24
Totali i kohës së lirë	04:34	05:53	05:11	03:39	05:20	04:32

Tabela 4.12: Përqindjet e popullsisë që kryejnë aktivitete të kohës së lirë sipas gjinisë dhe zonës urbane/rurale, popullsi shqiptare 10 vjeç e sipër, ditë jave

	Urbane			Rurale		
	Femra	Meshkuj	Të gjithë	Femra	Meshkuj	Të gjithë
TV dhe video	78	80	79	72	82	77
Shoqërizimi	49	46	48	47	40	43
Leximi	12	12	12	6	7	6
Hobi dhe lojëra	6	16	11	5	17	11
Sport	15	31	22	3	13	8
Punë vullnetare dhe ndihmë	2	2	2	2	2	2
Kompjuter	11	16	13	2	7	4
Argëtim	1	2	1	0	1	0
Pushim	50	53	51	58	65	62
Aktivitete të tjera të kohës së lirë	4	3	4	3	2	2
Udhëtim për kohën e lirë	45	73	58	24	60	43
Totali i kohës së lirë	97	99	98	96	99	98

Në tërësi, diferenca midis popullsisë urbane dhe asaj rurale duket e vogël. TV dominon te të dyja. Gratë rurale kalojnë më pak kohë duke parë televizor. Një pjesë më e madhe e burrave dhe grave urbane kalojnë kohë duke lexuar, në kompjuter dhe me sport. Ndryshe nga ç'mund të pritet, udhëtimi i lidhur me kohën e lirë është më i shpeshtë në zonat urbane se ato rurale.

4.2.3 Pasja e fëmijëve

Mosha e fëmijës më të vogël nuk ka ndikim të madh në sasinë apo në përmbajtjen e kohës së lirë. Diferencat gjinore dhe diferencat midis njerëzve me apo pa fëmijë nën 17 vjeç mbeten domethënëse për sasinë e kohës së lirë. Gratë kanë më pak kohë se Meshkujt dhe njerëzit pa fëmijë deri në 16 vjeç kanë më shumë kohë të lirë se ata me fëmijë.

Për të gjitha grupmoshat në tabelat 4.13 dhe 4.14 më poshtë, dominojnë tre aktivitete: TV, pushimi dhe shoqërimi. Aktiviteti që zë pjesën më të madhe të kohës së lirë është televizioni. Raportet variojnë nga 30 deri në 40 përqind të kohës totale të lirë. Gratë me fëmijë të vegjël shohin më pak televizor, vetëm pak më shumë se një orë, ndërsa Meshkujt pa fëmijë shohin më shumë televizor, rreth dy orë, ose pak më shumë. Të paktën dy në tre persona shohin televizor gjatë një dite të zakonshme. Koha e shoqërimit varion pak, nga gjysmë ore deri në treçerek ore. Raportet e pjesës së popullsisë janë rreth 50 përqind. Pushimi është gjithashtu një aktivitet i zakonshëm. Një në dy, dhe deri në dy në tre, persona pushojnë gjatë një dite të zakonshme. Koha mesatare minimale për të pushuar është 40 minuta për gratë me fëmijë të vegjël. Maksimumi është një orë e një çerek për personat me partnerë por pa fëmijë.

Tabela 4.13: Koha mesatare e shpenzuar për aktivitetet e kohës së lirë sipas gjinisë dhe pasjes së fëmijëve, popullsi shqiptare e moshës 15 vjeç e sipër, të gjitha ditët

	Me partner dhe fëmijë nën 7 vjeç			Me partner dhe fëmijë 7 - 16 vjeç			Me partner pa fëmijë nën 17 vjeç			Pa partner dhe pa fëmijë nën 17 vjeç		
	Femra	Meshkuj	Të gjithë	Femra	Meshkuj	Të gjithë	Femra	Meshkuj	Të gjithë	Femra	Meshkuj	Të gjithë
TV dhe video	01:05	01:49	01:26	01:26	01:49	01:37	01:27	02:11	01:49	01:55	02:01	01:58
Shoqërimi	00:32	00:28	00:30	00:38	00:41	00:39	00:46	00:47	00:46	00:46	00:44	00:45
Leximi	00:03	00:03	00:03	00:01	00:04	00:02	00:02	00:12	00:07	00:14	00:06	00:10
Hobi dhe lojëra	00:01	00:05	00:03	00:00	00:08	00:04	00:00	00:10	00:05	00:02	00:21	00:12
Sport	00:07	00:12	00:10	00:05	00:08	00:06	00:07	00:14	00:11	00:11	00:39	00:26
Punë vullnetare dhe ndihmë	00:00	00:03	00:01	00:00	00:01	00:01	00:02	00:02	00:02	00:02	00:02	00:02
Kompjuter	00:01	00:01	00:01	00:00	00:01	00:00	00:00	00:02	00:01	00:15	00:30	00:22
Argëtim	00:00	00:00	00:00	00:00	00:00	00:00	00:00	00:00	00:00	00:00	00:02	00:01
Pushim	00:40	00:56	00:48	00:48	00:59	00:53	01:15	01:19	01:17	01:06	00:57	01:01
Aktivitetet të tjera të kohës së lirë	00:01	00:02	00:01	00:00	00:00	00:00	00:00	00:02	00:01	00:03	00:01	00:02
Udhëtim për kohën e lirë	00:16	00:31	00:24	00:13	00:29	00:20	00:16	00:32	00:24	00:24	00:58	00:42
Totali i kohës së lirë	02:53	04:15	03:33	03:14	04:24	03:47	04:01	05:35	04:48	05:02	06:26	05:46

Tabela 4.14: Përqindjet e popullsisë që kryejnë aktivitete të kohës së lirë sipas gjinisë dhe pasjes së fëmijëve, popullsi shqiptare 15 vjeç e sipër, ditë jave.

	Me partner dhe fëmijë nën 7 vjeç			Me partner dhe fëmijë 7- 16 vjeç			Me partner dhe pa fëmijë nën 17 vjeç			Pa partner dhe pa fëmijë nën 17 vjeç		
	Femra	Meshkuj	Të gjithë	Femra	Meshkuj	Të gjithë	Femra	Meshkuj	Të gjithë	Femra	Meshkuj	Të gjithë
TV dhe video	69	80	74	75	82	78	72	83	77	78	78	78
Shoqërizimi	50	40	45	45	44	44	54	48	51	50	44	47
Leximi	7	6	7	3	7	5	3	14	9	16	7	11
Hobi dhe lojëra	3	6	4	1	7	4	1	10	6	4	19	12
Sport	10	13	11	5	8	7	7	15	11	13	30	22
Punë vullnetare dhe ndihmë	1	2	1	1	1	1	3	2	3	3	2	3
Kompjuter	2	2	2	1	2	2	2	2	2	15	23	19
Argëtim	0	0	0	0	0	0	0	1	1	0	2	1
Pushim	48	56	52	54	62	58	63	69	66	52	55	53
Aktivitetet tjera të kohës së lirë	4	2	3	0	0	0	2	3	2	5	3	4
Udhëtim për kohën e lirë	31	56	43	25	55	39	34	57	45	44	80	63
Totali i kohës së lirë	94	98	96	94	98	96	97	98	98	98	99	99

4.2.4 Statusi i punësimit

Të qenit jo në punësim do të thotë më shumë kohë e lirë se për personat e punësuar - për gratë një orë dhe për Meshkujt dy orë. Rreth gjysma e kësaj kohe të lirë i kushtohet televizorit. Pjesa tjetër shpërndahet midis aktiviteteve të tjera me disa variacione midis grave dhe burrave. Ka më shumë mundësi që numri i të rinjve të jetë më i lartë në grupin jo në punësim. Diferencat midis dy grupeve shkaktohet pjesërisht nga diferenca e moshës.

Personat jo në punësim shoqërizohen më tepër si në lidhje me kohën mesatare që i kushtojnë këtij aktiviteti edhe me raportin kohor. Shoqërizimi është një nga aktivitetet më dominante të kohës së lirë dhe zë mesatarisht 30 minuta deri në më pak se një orë. 40 deri në 50 përqind e këtyre njerëzve kalojnë kohën duke u shoqëruar gjatë një dite të zakonshme. Një tjetër aktivitet dominues i kohës së lirë është pushimi, që zë rreth një orë me plus-minus 10 minuta. Personat jo në punësim pushojnë pak më shumë. Tre aktivitete - sporti, hobi dhe lojërat, dhe kompjuteri - ndodhin shumë më shpesh dhe u kushtohet më shumë kohë nga Meshkujt e papunësuar. Ky supozohet të jetë një ndikim i moshës. Ka një diferencë përkatëse për gratë, por më pak e dallueshme dhe vetëm për sportin dhe kompjuterin.

Tabela 4.15: Koha mesatare e shpenzuar për aktivitetet e kohës së lirë sipas gjinisë dhe statusit të punësimit, popullsi shqiptare e moshës 15 vjeç e sipër, të gjitha ditët

	Në punësim			Jo në punësim		
	Femra	Meshkuj	Të gjithë	Femra	Meshkuj	Të gjithë
TV dhe video	01:02	01:37	01:24	01:50	02:35	02:06
Shoqërizimi	00:32	00:34	00:33	00:46	00:53	00:49
Leximi	00:03	00:04	00:04	00:08	00:11	00:09
Hobi dhe lojëra	00:00	00:07	00:04	00:02	00:23	00:10
Sport	00:05	00:12	00:09	00:10	00:40	00:21
Punë vullnetare dhe ndihmë	00:01	00:00	00:00	00:02	00:04	00:03
Kompjuter	00:02	00:05	00:04	00:07	00:24	00:13
Argëtim	00:00	00:00	00:00	00:00	00:02	00:01
Pushim	00:46	00:59	00:55	01:08	01:09	01:09
Aktivitete të tjera të kohës së lirë	00:00	00:01	00:00	00:02	00:02	00:02
Udhëtim për kohën e lirë	00:14	00:31	00:25	00:21	00:58	00:34
Totali i kohës së lirë	02:50	04:17	03:44	04:40	07:25	05:41

Tabela 4.16: Përqindjet e popullsisë që kryejnë aktivitete të kohës së lirë sipas gjinisë dhe statusit të punësimit, popullsi shqiptare 15 vjeç e sipër, ditë jave, të gjitha ditët

	Në punësim			Jo në punësim		
	Femra	Meshkuj	Të gjithë	Femra	Meshkuj	Të gjithë
TV dhe video	65	78	73	80	84	81
Shoqërizimi	42	40	40	54	52	53
Leximi	6	6	6	9	14	11
Hobi dhe lojëra	1	8	5	3	20	9
Sport	6	12	10	12	30	18
Punë vullnetare dhe ndihmë	2	1	1	3	4	3
Kompjuter	4	5	5	8	18	12
Argëtim	0	1	1	0	2	1
Pushim	51	60	57	57	60	58
Aktivitete të tjera të kohës së lirë	1	1	1	4	4	4
Udhëtim për kohën e lirë	26	58	46	40	77	54
Totali i kohës së lirë	94	98	97	98	99	98

5

ASPEKTE TË TJERA TË PËRDORIMIT TË KOHËS NË SHQIPËRI

5.1 Kujdesi për fëmijët

Studimi për përdorimin e kohës në Shqipëri përdor një ditar kohe për të mbledhur informacionin. Të intervistuarit plotësojnë ditarin për ditë të përzgjedhura rastësisht për një periudhë kohe. Në këtë rast për një vit të plotë. Në këta ditarë shënohen jo vetëm aktivitetet e kryera dhe koha kur fillon dhe kur mbaron aktiviteti, por edhe nëse është kryer ndonjë aktivitet tjetër pjesërisht; ku ndodh aktiviteti dhe nëse ishin të pranishëm persona të tjerë. Si rrjedhojë, ngjarjet e shënuara nuk karakterizohen vetëm nga aktiviteti kryesor, por edhe nga një sërë variablash shtesë që shërbejnë për të kuptuar më mirë se çfarë po ndodh.

Kur u adresua shkurtimisht koha e përdorur nga gratë dhe nga Meshkujt për t'u kujdesur për fëmijët në seksionin 3.5, matja ishte konservative sepse vetëm kujdesi ndaj fëmijëve u konsiderua si aktivitet kryesor. Por duke përdorur edhe të dhënat e tjera shtesë në ditar, imazhi statistikor i kohës së shpenzuar për kujdesin për fëmijët do të bëhet më realist dhe më i rëndësishëm.

Nuk është e thjeshtë të përkufizohet çfarë është apo çfarë nuk është kujdesi për fëmijët. Mund të jenë të mundshme disa përkufizime të ndryshme alternative në varësi të objektivave. Grafiku 5.1 dhe Tabela 5.1 më poshtë tregojnë një sërë situatash që mund të konsiderohen si zëvendësuese të kujdesit për fëmijët dhe të shtohen te aktiviteti kryesor për të bërë një matje më të saktë. E para e shtuar është kujdesi për fëmijët si aktivitet dytësor, d.m.th shënohet si aktivitet dytësor kur aktiviteti kryesor nuk është kujdesi për fëmijët. Një tjetër shtesë janë vaktet kur fëmijët²² janë të pranishëm dhe nuk ka ndonjë tregues tjetër që kujdesi për fëmijët është aktivitet parësor apo dytësor. Një shtesë e tretë që mund të konsiderohet ose jo, në varësi të lexuesit, si kujdes për fëmijët janë aktivitete të papaguara²³ në praninë e fëmijëve. Shtesa e fundit janë aktivitetet e kohës së lirë në praninë e fëmijëve.

22 Në udhëzimet HETUS dhe në studimin shqiptar, prania e fëmijëve deri në 9 vjeç shënohet në ditar. Ky është informacioni i përdorur këtu dhe për të gjitha shtesat e tjera ku fëmijët janë të pranishëm.

23 Aktivitet që tregojnë kujdes për fëmijët janë përfshirë në kategorinë një shifrore të punës së papaguar dhe janë lënë jashtë këtu. Po kështu edhe udhëtimi në lidhje me punën e papaguar.

Grafiku 5.1: Koha mesatare e shpenzuar për aktivitete që mund të tregojnë kujdes për fëmijët sipas gjinisë dhe pasjes së fëmijëve, Popullsia shqiptare 20 – 74 vjeç, të gjitha ditët




Tabela 5.1: Përqindjet e popullsisë që kryejnë aktivitete që mund të përfshijnë kujdes për fëmijët, sipas gjinisë dhe të pasurit fëmijë, Popullsia shqiptare 20-74 vjeç, të gjitha ditët

	Me partner dhe fëmijë nën 7 vjeç			Me partner dhe fëmijë 7- 16 vjeç		
	Femra	Meshkuj	Të gjithë	Femra	Meshkuj	Të gjithë
Aktiviteti kryesor - kujdesi për fëmijët	86	27	57	38	9	24
Aktiviteti dytësor – kujdesi për fëmijët	17	10	14	5	1	3
Koha e lirë në praninë e fëmijëve deri në 9 vjeç	53	47	50	11	11	11
Vakte me fëmijët deri në 9 vjeç	54	46	50	12	12	12
Punë e papaguar me fëmijë deri në 9 vjeç	55	7	31	14	1	8
Koha totale e kujdesit për fëmijët	93	65	79	43	20	32

Grafiku 5.1 tregon kohën për ngjarje që mund të tregojnë kujdes për fëmijët në kuptimin e gjerë. Nëse pranohen të gjithë variablat e tjera si të lidhura me kujdesin për fëmijët, koha mesatare e tejkalon dukshëm aktivitetin kryesor - kujdesi për fëmijët. Gratë me partner dhe fëmija më i ri deri në 6 vjeç i dyfishojnë, ose edhe më tepër, përpjekjet e tyre, nga dy orë e gjysmë deri në gjashtë orë në ditë. Shtesat përbëhen nga 10 minuta kujdes për fëmijët si aktivitet dytësor, gjysmë ore vakt bashkë me fëmijët, përkatësisht një orë dhe një orë e dyzet minuta aktiviteteve të kohës së lirë dhe pune të papaguar. Koha e shpenzuar nga Meshkujt për t'u kujdesur për fëmijët është rritur, nga 20 minuta si aktivitet kryesor në dy orë e treçerek minuta - pothuajse gjashtë herë

më tepër. Pjesa kryesore e rritjes janë aktivitetet e kohës së lirë në praninë e fëmijëve - një orë e një çerek. Vaktet e konsumuara bashkë me fëmijët kontribuojnë po këtë sasi kohe për gratë, rreth një orë. Dy shtesat e tjera kontribuojnë vetëm marxhinalisht.

Në rastin e fëmijëve më të mëdhenj (7-16 vjeç) situata ndryshon. Raportet e shënimeve të aktiviteteve për kujdesin për fëmijët dhe koha e kaluar për këto aktivitete janë më të vogla.

5.2 Konteksti social

Siç përmendet më sipër, të intervistuarve iu kërkua të shënojnë në ditar nëse kanë qenë vetëm apo me një person tjetër gjatë ditës së shënuar në ditar, dhe nëse po, kush ishte. U kërkua prezenca e personave të pesë kategorive; anëtarë të familjes: partner, prindër, fëmijë deri në 9 vjeç, anëtarë të tjerë dhe anëtarë jo të familjes: persona që njohin të intervistuarit. Të qenit i pranishëm nuk kërkon domosdoshmërisht ndërveprim. Të intervistuarit janë udhëzuar të kuptojnë se prania e një personi (personash) nënkupton që personi të jetë aty, d.m.th në të njëjtën dhomë ose në një dhomë afër.

Informacioni për praninë e anëtarëve të familjes deri në 9 vjeç në lidhje me disa aktivitete të caktuara u përdor në seksionin e mëparshme për kujdesin për fëmijët. Në këtë seksion shpjegohet konteksti social për një grup të vogël aktivitete. Në tabelat në vijim, personat e tjerë grupohen në: partner, fëmijë, d.m.th anëtar i familjes deri në 9 vjeç dhe persona të tjerë, anëtarë të familjes ose jo anëtarë të familjes.

Koha e vlerësuar në praninë e, për shembull, partnerit, në tabelat në vijim nënkupton kohën totale me partnerin, pavarësisht pranisë së fëmijëve apo personave të tjerë. Për këtë arsye, koha me 'partnerin', 'fëmijën' dhe 'tjetër' nuk është domosdoshmërisht përmbledhje e kategorisë kohë 'jo vetëm'. Disa persona në familjet me një person kanë shënuar se kanë ngrënë një vakt në praninë e një fëmije apo partneri që duhet të jenë anëtarë të familjes së të intervistuarit sipas udhëzimeve të dhëna në ditar. Kjo mund të tregojë ndonjë keqkuptim të udhëzimeve dhënë të intervistuarve. Është një gabim matjeje jo i rëndësishëm.

Ndryshe nga familjet e tjera, pothuajse çdo person që jeton në familje me një person kalon të paktën disa nga vaktet vetëm. Në këtë grup, janë gratë ato që në krahasim me Meshkujt kalojnë më shumë kohë duke ngrënë (ose duke pirë kafe) vetëm. Meshkujt kalojnë në përgjithësi më shumë kohë duke ngrënë, dhe një pjesë e mirë e kësaj kohe kalohet në shoqërinë e personave të tjerë. Ky rezultat përputhet me faktin që Meshkujt kalojnë më shumë kohë se gratë duke ngrënë ose duke pirë kafe në restorante (Seksioni 5.3).

Të kesh fëmijë deri në 9 vjeç nuk do të thotë se pjesa kryesore e vakteve konsumohet në praninë e fëmijëve. Më pak se gjysma e femrave dhe e meshkujve shënojnë në ditar se kanë ngrënë një vakt në praninë e fëmijëve të tyre. Prania e personave të tjerë është shumë më e zakonshme.

Mund të duket e çuditshme që gratë me partner kalojnë më pak kohë duke ngrënë një vakt me partnerin dhe e anasjellta. Megjithatë kjo është e drejtpërdrejtë sepse nuk ka asnjë kusht që tregon se po ndodh i njëjti aktivitet. Një situatë që do të ishte në përputhje me këtë lloj rezultati është fakti që Meshkujt, shumë më shpesh se gratë, hanë një vakt në praninë e partneres por që e cila jo domosdoshmërisht po ha në të njëjtën kohë, por mund të jetë duke gatuar ose duke kryer një punë tjetër shtëpie.

Me përjashtim të personave në familje me një person, ka shumë pak variacion në kohën e kaluar duke ngrënë vetëm – vazhdimisht më pak se 20 minuta; ndërsa në praninë e një personi tjetër, rreth dy orë ose pak më pak.

Tabela 5.2: Koha mesatare për vaktet së bashku me persona të tjerë sipas gjinisë dhe situatave të ndryshme familjare, Populli shqiptarë 20-74 vjeç, të gjitha ditët

Vakte, kafe	Familje me një person			Me partner dhe fëmijë 0-9 vjeç			Me partner dhe pa fëmijë 0-9 vjeç			Tjetër		
	Femra	Meshkuj	Të gjithë	Femra	Meshkuj	Të gjithë	Femra	Meshkuj	Të gjithë	Femra	Meshkuj	Të gjithë
Vetëm	01:28	01:16	01:23	00:08	00:12	00:10	00:12	00:10	00:11	00:19	00:20	00:19
Jo vetëm nga të cilët:												
Me partner	00:00	00:05	00:02	00:34	00:48	00:41	00:59	01:06	01:02	00:01	00:02	00:01
Me fëmijë	00:02	00:00	00:01	00:30	00:27	00:28	00:03	00:00	00:02	00:09	00:03	00:06
Me tjetër	00:43	01:20	00:58	01:14	01:34	01:24	01:14	01:33	01:23	01:31	01:54	01:43
Totali	02:13	02:42	02:25	01:49	02:20	02:04	02:03	02:26	02:14	02:00	02:32	02:16

Tabela 5.3: Përqindjet e popullsisë që hanë vakte së bashku me persona të tjerë sipas gjinisë dhe situatave të ndryshme familjare, Populli shqiptarë 20-74 vjeç, të gjitha ditët

Vakte, kafe	Familje me një person			Me partner dhe fëmijë 0-9 vjeç			Me partner dhe pa fëmijë 0-9 vjeç			Tjetër		
	Femra	Meshkuj	Të gjithë	Femra	Meshkuj	Të gjithë	Femra	Meshkuj	Të gjithë	Femra	Meshkuj	Të gjithë
Vetëm	98	89	95	24	29	26	32	27	30	37	44	41
Jo vetëm nga të cilët:												
Me partner	0	6	3	55	66	60	73	76	74	2	4	3
Me fëmijë	2	0	1	46	39	43	6	3	4	12	5	9
Me tjetër	57	75	64	81	88	85	81	85	83	89	88	89
Totali	100	100	100	99	100	99	100	100	100	100	100	100

Personat në familje me një person dhe veçanërisht gratë, kalojnë një pjesë të mirë të kohës së tyre të lirë vetëm. Për Meshkujt raporti është 50 me 50 dhe për gratë dy të tretat e kohës totale të lirë. Për personat në grupin ‘tjetër’ është 25 përqind dhe 20 përqind përkatësisht. Në rastin e të pasurit një partner, raporti shkon në 10 përqind ose pak më shumë; megjithatë bëjnë përjashtim gratë pa fëmijë të vegjël me 23 përqind.

Në përgjithësi Meshkujt shpenzojnë rreth një orë më shumë kohë të lirë se femrat në praninë e personave të tjerë (d.m.th “jo vetëm”). Meshkujt me fëmijë të vegjël (deri

në 9 vjeç) shpenzojnë pothuajse të njëjtën sasi kohe të lirë (rreth një orë) në praninë e fëmijëve. Por mund të ketë një diferencë të vogël në pjesën e kohës totale të lirë - Meshkujt pak më pak kohë se gratë.

Më pak se gjysma e femrave dhe e meshkujve shënojnë në ditar se kalojnë kohë të lirë në praninë e fëmijëve. Prania e personave të tjerë është shumë më e zakonshme.

Meshkujt me partnere kalojnë shumë më tepër kohë të lirë në praninë e partneres se e anasjellta. Kjo interpretohet në mënyrë të tillë që Meshkujt e shijojnë kohën e lirë në praninë e partneres, pavarësisht se partnerja mund të jetë duke kryer një aktivitet tjetër. Për shkak se janë gratë ato që kryejnë pothuajse të gjitha punët pa pagesë, ka shumë gjasa që të jenë duke kryer pikërisht këto aktivitete.

Tabela 5.4: Koha mesatare për aktivitete të kohës së lirë së bashku me persona të tjerë sipas gjinisë dhe situatave të ndryshme familjare, Popullsia shqiptare 20-74 vjeç, të gjitha ditët, orët dhe minutat

Koha e lirë, udhëtimi total i përjashtuar	Familje me një person			Me partner dhe fëmijë 0-9 vjeç			Me partner dhe pa fëmijë 0-9 vjeç			Tjetër		
	Femra	Meshkuj	Të gjithë	Femra	Meshkuj	Të gjithë	Femra	Meshkuj	Të gjithë	Femra	Meshkuj	Të gjithë
Vetëm	03:29	02:29	03:04	00:20	00:25	00:22	00:45	00:37	00:41	01:10	01:07	01:09
Jo vetëm nga të cilët:												
Me partner	00:00	00:03	00:01	00:49	01:33	01:11	01:14	02:07	01:39	00:01	00:04	00:02
Me fëmijë	00:03	00:00	00:02	00:56	01:03	00:59	00:06	00:01	00:03	00:15	00:03	00:09
Me tjetër	01:33	02:25	01:55	01:51	02:22	02:06	01:48	02:33	02:09	02:50	03:44	03:17
Totali	05:03	04:56	05:01	02:58	03:54	03:25	03:20	04:27	03:52	04:21	05:20	04:51

Tabela 5.5: Përqindjet e popullsisë që kryejnë aktivitete të kohës së lirë me persona të tjerë sipas gjinisë dhe situatave të ndryshme familjare, popullsia shqiptare 20-74 vjeç, të gjitha ditët, përqindja

Koha e lirë, udhëtimi total i përjashtuar	Familje me një person			Me partner dhe fëmijë 0-9 vjeç			Me partner dhe pa fëmijë 0-9 vjeç			Tjetër		
	Femra	Meshkuj	Të gjithë	Femra	Meshkuj	Të gjithë	Femra	Meshkuj	Të gjithë	Femra	Meshkuj	Të gjithë
Vetëm	97	88	93	26	27	26	46	36	41	49	51	50
Jo vetëm nga të cilët:												
Me partner	1	2	1	50	59	54	59	69	64	2	4	3
Me fëmijë	3	0	2	44	41	43	6	1	4	13	3	8
Me tjetër	67	66	67	76	79	77	74	78	76	86	91	89
Totali	99	99	99	94	98	96	96	98	97	98	99	98

Televizori zë një pjesë të mirë të kohës së personave në familje me një person kur janë vetëm. Nuk ndodh e njëjta gjë kur të intervistuarit kanë një partner; vetëm një pjesë e vogël shohin televizor vetëm. Për personat me fëmijë deri në 9 vjeç, rreth një e treta e kohës totale të shpenzuar për televizor ndodh në praninë e fëmijëve. Më pak se gjysma e personave në shtëpi me fëmijë të vegjël shënojnë se kanë parë televizor në praninë e fëmijëve.

Tabela 5.6: Koha mesatare duke parë televizor së bashku me persona të tjerë sipas gjinisë dhe situatave të ndryshme familjare, Popullsia shqiptare 20-74 vjeç, të gjitha ditët

Shikimi i televizorit	Familje me një person			Me partner dhe fëmijë 0-9 vjeç			Me partner dhe pa fëmijë 0-9 vjeç			Tjetër		
	Femra	Meshkuj	Të gjithë	Femra	Meshkuj	Të gjithë	Femra	Meshkuj	Të gjithë	Femra	Meshkuj	Të gjithë
Vetëm	01:47	01:26	01:38	00:07	00:08	00:07	00:16	00:11	00:14	00:27	00:31	00:29
Jo vetëm nga të cilët:												
Me partner	00:00	00:01	00:00	00:22	00:57	00:39	00:34	01:12	00:53	00:00	00:01	00:00
Me fëmijë	00:00	00:00	00:00	00:21	00:37	00:29	00:05	00:00	00:02	00:06	00:00	00:03
Me tjetër	00:11	00:05	00:08	00:49	00:59	00:54	00:47	01:04	00:55	01:13	01:10	01:11
Totali	01:58	01:33	01:48	01:16	01:48	01:31	01:25	02:00	01:42	01:51	01:57	01:54

Tabela 5.7: Përqindjet e popullsisë që shohin televizor bashkë me persona të tjerë, sipas gjinisë dhe situatave të ndryshme familjare, Popullsia shqiptare 20-74 vjeç, të gjitha ditët

Shikimi i televizorit	Familje me një person			Me partner dhe fëmijë 0-9 vjeç			Me partner dhe pa fëmijë 0-9 vjeç			Tjetër		
	Femra	Meshkuj	Të gjithë	Femra	Meshkuj	Të gjithë	Femra	Meshkuj	Të gjithë	Femra	Meshkuj	Të gjithë
Vetëm	73	62	68	10	10	10	21	15	18	26	27	26
Jo vetëm nga të cilët:												
Me partner	0	1	1	33	48	40	38	56	47	1	1	1
Me fëmijë	2	0	1	25	32	29	5	1	3	7	0	4
Me tjetër	15	6	11	50	48	49	49	54	51	60	53	57
Totali	80	63	73	71	79	75	73	83	78	78	76	77

5.3 Vendndodhja

Në ditar shënohet se ku ndodhin aktivitetet (apo ngjarjet e tjera). Informacioni për vendndodhjen klasifikohet në një grup të kufizuar kategorish. Vendndodhja për një grup të vogël aktiviteteve si vaktet, shoqërimi dhe koha e lirë paraqiten në këtë seksion.

Vaktet përfshijnë pirjen e kafes; shoqërimi është një aktivitet kryesor dy shifror që përfshin një sërë aktiviteteve tre shifrore të cilat tregojnë lloje të ndryshme aktiviteteve sociale (shihni Shtojcën C); koha e lirë është totali i aktiviteteve të kohës së lirë, me përjashtim të udhëtimit të kryer në lidhje me këto aktivitete. Vendndodhja klasifikohet në katër kategori: në shtëpi, në shtëpinë e dikujt tjetër, në restorant dhe në vende të tjera. Bëhen vlerësime të ndara për ditët e javës dhe për fundjavat.

Tabelat 5.8 dhe 5.9 tregojnë se shumica e vakteve konsumohen në shtëpi dhe nuk ka diferenca midis femrave dhe meshkujve apo ditëve të javës dhe fundjavave. Megjithatë ka një diferencë gjinore për sa i përket vakteve të konsumuara jashtë

Udhëtime/rrugë që lidhen me studimet	00:10	00:08	00:09	00:12	00:09	00:11	00:05	00:04	00:05
Studimi gjithsej	01:22	01:09	01:16	01:41	01:23	01:33	00:34	00:34	00:34
TV dhe video	01:52	01:58	01:55	01:49	01:55	01:52	01:59	02:05	02:02
Socializim	00:34	00:36	00:35	00:31	00:34	00:33	00:39	00:43	00:41
Lexim	00:11	00:12	00:11	00:09	00:11	00:10	00:16	00:14	00:15
Hobby-t dhe lojërat	00:06	00:15	00:10	00:04	00:15	00:09	00:12	00:15	00:14
Sporte	00:14	00:28	00:21	00:11	00:25	00:18	00:19	00:36	00:27
Punë vullnetare dhe ndihmë për të tjerët	00:01	00:03	00:02	00:00	00:03	00:01	00:02	00:02	00:02
Kompjuter	00:13	00:20	00:16	00:12	00:19	00:16	00:13	00:23	00:18
Argëtim	00:02	00:02	00:02	00:00	00:02	00:01	00:05	00:03	00:04
Pushim/Shlodhje	00:54	00:55	00:55	00:52	00:55	00:53	00:59	00:55	00:57
Aktivitetet të tjera të kohës së lirë	00:03	00:02	00:02	00:02	00:02	00:02	00:04	00:02	00:03
Udhëtime lidhur me kohën e lirë	00:25	00:47	00:36	00:18	00:40	00:29	00:45	01:03	00:54
Kohë e lirë gjithsej	04:39	05:43	05:10	04:15	05:26	04:49	05:40	06:26	06:02
Të tjera	00:04	00:06	00:05	00:01	00:01	00:01	00:11	00:19	00:15
Gjithsej	24	24	24	24	24	24	24	24	24
Numri i ditëve (të pa peshuar)	646	523	1,169	330	269	599	316	254	570

Tabela A.59: Shkallët e pjesëmarrjes në aktivitetet kryesore sipas gjinisë dhe llojit të ditës, Tiranë

Popullsia e moshës 10 vjeç e lart									
	Të gjitha ditët			Ditë jave			Ditë fundjave		
Aktiviteti kryesor	Femra	Meshkuj	Të gjithë	Femra	Meshkuj	Të gjithë	Femra	Meshkuj	Të gjithë
	Në përqindje (%)								
Punë e paguar	25	46	35	31	50	40	9	37	23
Udhëtimi për në punë/nga puna	23	44	33	29	47	38	8	36	21
Punë e paguar gjithsej	25	47	36	31	51	41	9	37	23
Fjetja	100	100	100	100	100	100	100	100	100
Ngrënja	100	100	100	100	100	100	100	100	100
Higjena personale	94	93	94	94	93	94	94	93	94
Aktivitet personale gjithsej	100	100	100	100	100	100	100	100	100
Përgatitja e ushqimit, larja e enëve	75	20	49	76	22	50	74	16	46
Pastrimi dhe punë të tjera	60	9	36	58	8	34	64	12	39
Larje rrobash, hekurosje, punë dore dhe prodhime tekstilësh	32	2	18	31	1	17	34	4	19
Kopshtari, ndërtime & riparime	3	8	6	4	8	6	2	7	5
Pazari dhe shërbime të tjera	39	22	31	41	21	31	34	24	29
Kujdesi për fëmijët	30	9	20	31	10	21	30	8	19
Kujdesi për të rriturit	5	3	4	4	2	3	6	5	5
Punë të tjera të papaguara	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Udhëtime/rrugë që lidhen me punë të papaguara	41	23	32	43	23	33	35	25	30
Punë e papaguar gjithsej	88	48	69	87	49	69	91	46	70
Studimi/mësimi	20	18	19	22	20	21	14	13	14
Udhëtime/rrugë që lidhen me studimet	16	16	16	19	19	19	6	8	7
Studimi gjithsej	20	18	19	22	20	21	14	13	14
TV dhe video	78	77	78	79	75	77	77	83	80
Socializim	47	43	45	47	41	44	47	46	47
Lexim	18	14	16	16	13	15	21	17	19
Hobby-t dhe lojërat	7	15	11	6	15	10	9	15	12
Sporte	15	27	21	14	24	19	18	35	26
Punë vullnetare dhe ndihmë për të tjerët	1	3	2	0	3	2	2	2	2
Kompjuter	14	20	17	14	19	16	15	22	18
Argëtim	1	2	2	1	2	1	3	3	3
Pushim/Shlodhje	51	57	54	51	58	55	51	55	53
Aktivitete të tjera të kohës së lirë	7	3	5	8	4	6	6	3	5
Udhëtime lidhur me kohën e lirë	45	71	58	40	66	52	58	84	71
Kohë e lirë gjithsej	99	100	99	98	99	99	100	100	100
Të tjera	6	6	6	4	5	5	12	9	10

Burimi: Studimi Shqiptar për Përdorimin e Kohës, 2010-2011

Përshkrim teknik dhe vlerësim

1. Përshkrim i përgjithshëm

Studimi Shqiptar mbi Përdorimin e Kohës (SSHPK) aplikon udhëzimet e Eurostat-it për Studimet e Harmonizuara Europiane për Përdorimin e Kohës (HETUS). Në udhëzime janë përshkruar tërësisht konceptet e HETUS-it. Informacioni për përdorimin e kohës mbledhet nëpërmjet një ditari me intervale kohore fikse (10 minutëshe) në të cilin personat e intervistuar vetë-registrojnë përdorimin e kohës së tyre për dy ditë ditari të përzgjedhura në mënyrë të rastësishme. Në ditar regjistrohet një aktivitet kryesor, një aktivitet paralel ose i njëkohshëm, vendi ku kryhet aktiviteti, mjetet e transportit dhe prania e personave të tjerë. Personat që morën pjesë në studim u intervistuan disa ditë më parë ditëve të përzgjedhura për plotësimin e ditarëve, dhe i'u përgjigjën pyetjeve të dy pyetësorëve që lidhen me kushtet e njësisë ekonomike familjare dhe ato individuale. Metoda e HETUS-it është e dokumentuar me detaje nga Eurostat-i¹.

2. Popullsia

Popullsia e synuar për Studimin Shqiptar mbi Përdorimin e Kohës përfshin të gjithë rezidentët në Shqipëri të moshës 10 vjeç e lart. Njësia e zgjedhjes është familja (njësia ekonomike familjare) dhe të gjithë anëtarëve të familjes 10 vjeç e lart i'u kërkua të merrnin pjesë në studim.

3. Dizenjimi i kampionit, madhësia e zgjedhjes

Baza e zgjedhjes e përdorur për SSHPK-në bazohet në të dhënat përmbledhëse për zonat e numërimit nga Regjistrimi i Popullsisë dhe Banesave në Shqipëri i vitit 2001. Ajo është stratifikuar (shtresëzuar) në katër zona (strata) gjeografike (Qëndrore, Bregdetare, Malore, dhe Tirana urbane). Tabela më poshtë tregon shpërndarjen e zonave të numërimit dhe familjeve në bazën e zgjedhjes sipas rajoneve dhe zonës urbane dhe rurale bazuar në rezultatet e Regjistrimit të Popullsisë dhe Banesave në Shqipëri të vitit 2001. Kampioni është zgjedhur në mënyrë të pavarur në secilën stratë sipas një procedure zgjedhjeje dy-hapëshe.

¹ Udhëzimet gjenden në adresën:
http://epp.eurostat.ec.europa.eu/cache/ITY_OFFPUB/KS-RA-08-014/EN/KS-RA-08-014-EN.PDF

TabelaB1: Shpërndarja e kampionit

Zona gjeografike	Strata	Numri i PSU-ve në bazën e zgjedhjes ²	Numri i familjeve në bazën e zgjedhjes ³	Numri i PSU-ve të zgjedhura nga baza e zgjedhjes	Numri i familjeve të zgjedhura
Qëndrore	Shkodër	278	20,331	10	50
	Elbasan	220	20,604	10	50
	Berat	123	9,841	10	50
	Korçë	179	13,879	10	50
	Zona të tjera urbane	573	46,724	20	100
	Rurale	2,485	203,013	65	325
	Nëntotali	3,858	314,392	125	625
Bregdetare	Durrës	306	24,323	10	50
	Fier	168	14,098	10	50
	Vlorë	241	19,393	10	50
	Zona të tjera urbane	510	41,199	30	150
	Rurale	1,479	122,747	65	325
	Nëntotali	2,704	221,760	125	625
Malore	Zona të tjera urbane	172	15,044	50	250
	Rurale	658	53,061	75	375
	Nëntotali	830	68,105	125	625
Tirana	I ulët	268	22,105	17	85
	Mesatar	452	36,769	31	155
	I lartë	359	28,633	27	135
	Nëntotali	1,079	87,507	75	375
	Gjithsej	8,471	691,764	450	2,250

Në hapin e parë janë zgjedhur me një probabilitet përpjesëtimor lidhur me madhësinë e zonës së numërimit 450 njësi primare statistikore (PSU). Në hapin e dytë, në secilën PSU u zgjodh një numër fiks prej 5 familjesh sipas metodës së zgjedhjes sistematike me probabilitet të barabartë. Lista nga e cila u zgjodhën këto 5 familje ishte përditësuar më së fundi në Prill 2008 dhe prandaj nuk ishte plotësisht e përditësuar. Prandaj, për çdo PSU u zgjodhën dhe 3 familje të tjera për t'u përdorur si rezervë nëse njëra ose disa prej familjeve origjinale nuk gjendeshin apo refuzonin të merrnin pjesë në studim.

4. Zgjedhja e ditëve të ditarit

Në studimet e përdorimit të kohës personave të intervistuar u kërkohet të plotësojnë ditarët e kohës për ditët e përcaktuara të zgjedhuara në mënyrë të rastësishme, dhe që përfaqësojnë një periudhë kohe të caktuar, në rastin e SSHPK-së një vit të plotë që fillon më 1 Mars 2010 dhe vijon në 12 muajt në vazhdim. Për secilën familje u përzgjedhën dy ditë ditari, një ditë e zakonshme jave (nga e Hëna në të Premte) dhe një ditë fundjave (E Shtunë ose E Diel). Në rastin kur familja dhe/ose një apo më shumë

² Regjistrimi i Popullsisë dhe Banesave 2001

³ Regjistrimi i Popullsisë dhe Banesave 2001

anëtarë të familjes nuk mund ta plotësonin ditarin në ditët e përzgjedhura, dizenjimi i studimit lejonte shtyrjen e të njëjtës ditë të javës deri në tre javë më vonë. Shtyrja e mbajtjes së ditarit duhet të shmanget sa më shumë të jetë e mundur.

Të gjithë anëtarëve të familjes të moshës 10 vjeç e lart në familjet e zgjedhura i'u kërkua që të japnin informacion mbi përdorimin e kohës së tyre nëpërmjet vetë-plotësimit të ditarëve.

5. Puna në terren

SSHPK-ja u krye në terren nga data 1 Mars 2010 deri në fund të muajit Shkurt 2011. Para ditëve të përzgjedhura të ditarit me anëtarët e familjeve të zgjedhura u kryen intervista ballë për ballë. Njëra intervistë lidhej me kushtet e familjes, p.sh me përbërjen e familjes. Intervistat u kryen gjithashtu me individët anëtarë të familjeve të përfshira në kampion.

Ditarët u lanë në familje për t'u plotësuar në ditët e përcaktuara të ditarit nga secili anëtar i familjes i moshës 10 vjeç e lart.

6. Kodimi i aktiviteteve

Ditarët u koduan në INSTAT sipas një sistemi kodesh për aktivitetet të HETUS-it paksa të modifikuar. Procesi i kodimit është i vështirë dhe një burim potencial për gabimet e matjes. Prandaj, për kryerjen e kësaj detyre u rekrutua dhe u trajnua mirë një personel kodues.

Aktivitetet e regjistruara në ditarët e kohës nga të intervistuarit u koduan në përputhje me Listën e kodeve të Aktiviteteve 2008 (ACL2008⁴, shih shtojcën C). Aktivitetet kryesore dhe aktivitetet paralele u koduan me kodet tre shifrore, ndërsa kodet u vunë dhe për vendndodhjen/mënyrën e transportit. Personeli kodues shënoi gjithashtu fillimin dhe përfundimin e ngjarjeve. Me qëllim që të zbuloheshin dhe korrigjoheshin gabimet, e kështu të rritej saktësia e të dhënave, i njëjti personel bëri kodimin dhe hedhjen e të dhënave.

7. Përpunimi i të dhënave

Programi për hedhjen e të dhënave që u pregatit posaçërisht për këtë punë, është një aplikacion i Basic Visio 2005. Për përpunimin e të dhënave, pra për organizimin e të dhënave, pastrimin e të dhënave, prodhimin e tabelave, etj, u përdor SPSS software. Për llogaritjen e peshave dhe teknikat e kalibrimit u përdor SAS software.

8. Peshimi

Kampioni i Studimit Shqiptar për Përdorimin e Kohës është përfaqësues për katër zonat e studimit (rajonet gjeografike), për zonat urbane dhe rurale, dhe për vendin në tërësi. Peshat janë llogaritur në disa hapa duke marrë parasysh dizenjimin e kampionit, rregullimet për mos-përgjigjen në nivel familjeje, kalibrimin e të dhënave demografike,

4 Studimet e Harmonizuara Europiane për Përdorimin e Kohës, udhëzime

dhe shpërndarjen e ditëve të ditarit.

Në hapin e parë, u llogaritën peshat bazë të përzgjedhjes si e anasjellta e probabilitetit të përzgjedhjes së secilës familje në shtresën i të stratës h në kampion, duke marrë parasysh probabilitetin e përzgjedhjes si dhe probabilitetin e përgjigjes .

$$W_{hi} = \frac{M_h}{n_h \times M_{hi}} \times \frac{M'_{hi}}{m_{hi}}, \text{ ku}$$

W_{hi} : Pesha bazë e përzgjedhjes e familjes i në PSU-në e stratës h

M_h : Numri total i banesave në stratën h (sipas Censurit 2001)

n_h : Numri i PSU-ve të zgjedhura në stratën h

M_{hi} : Numri i familjeve në PSU-në i të statës h

M'_{ih} : Numri i familjeve në listën e përditësuar të familjeve në PSU-në i të stratës h

m_{hi} : Numri i familjeve të përzgjedhura në PSU-në i të stratës h

Këto dy komponentë i korrespondojnë përkatësisht procedurës dy-hapëshe të zgjedhjes. Komponentja e parë rrjedh nga metoda e zgjedhjes me probabilitet përpjesëtimor lidhur me madhësinë dhe baza e zgjedhjes së PSU-ve, ndërsa komponentja e dytë rrjedh nga metoda e zgjedhjes sistematike dhe lista e përditësuar e familjeve të PSU-ve.

Meqë procedura e zgjedhjes së PSU-ve është bërë në SAS, komponentja e parë është gjeneruar në software SAS përmes procedurës së PPS sistematike.

Në hapin e dytë, pesha është rregullur më tej për mos-përgjigjen në nivel familjeje me qëllim që të parandalohen shmangiet e shkaktuara nga mos-përgjigjia. Për të llogaritur faktorët rregullues të përshtatshëm të peshave u përdorën rezultatet përfundimtare të intervistimit të familjeve. Për secilën PSU u mbledh informacion nëpërmjet raportit të anketuesit mbi arsyet se pse u përdorën familjet rezervë. Lista e mëposhtme është një listë e kategorive të rezultateve, informacion ky i mbledhur për secilën PSU në raportin e anketuesit:

1. Intervistë e përfunduar plotësisht
2. Refuzim
3. E gjithë familja mungonte për një periudhë të gjatë kohe
4. Banesa nuk u gjet
5. Banesa bosh, adresa jo e një banese
6. Banesë e shkatërruar
7. Tjetër, specifiko

Pesha e rregulluar për secilën familje në PSU-në i të stratës h jepet nga:

$$W'_{hi} = W_{hi} \times \frac{m'_{hi}}{m_{hi}}, \text{ ku}$$

m_{hi} : Numri total i familjeve *jo në interes të studimit (out-of scope)* në PSU-në *i të stratës h*

m_{hi}^n : Numri total i familjeve që e plotësuan intervistën në PSU-në *i të stratës h*

Kjo peshë ishte e njëjtë për të gjithë anëtarët e familjes pasi për rregullimin për mos-përgjigjen në nivel familjeje u përdor teknika e kalibrimit.

Në hapin e tretë, u llogarit pesha për ditarin. Pesa e ditarit u llogarit **për të gjithë ditarët dhe ajo përfshinte** rregullimet për mos-përgjigjet për ditarët që mungonin. Këto pesha u kalibruan për popullsinë e vitit 2010 në rajone, zonat urbane dhe rurale, dhe sipas grup-moshave, prandaj pesha është e njëjtë për të gjithë anëtarët e familjes, pasi teknika e kalibrimit u përdor në nivel familjeje. Përsëri procedura e kalibrimit u bë në SAS software.

Peshat përfundimtare për ditarët u morën nga shumëzimi i peshave të kalibruara të ditarit me 5/7 në rastin e ditëve të zakonshme të javës dhe me 2/7 në rastin e ditëve të fundjavës.

9. Vlerësim i përmbledhur i rezultateve të studimit

Më poshtë jepen shkurtimisht disa tregues mbi cilësinë e rezultateve të studimit shqiptar. Për të vlerësuar rezultatet ka disa burime ku mund të gjenden rezultate të ngjashme nga studime të tjera mbi përdorimin e kohës dhe të bëhen krahasime me to. Një nga këto burime janë metadat e 15 studimeve kombëtare të përdorimit të kohës të përfshira në mjetin gjenerues të tabelave të HETUS të cilat janë të aksesueshme në internet⁵. Një burim tjetër është vlerësimi i Eurostat-it për Studimet Europiane Pilote të Përdorimit të Kohës⁶. Më poshtë këto dy burime janë përdorur si referenca.

Shkallët e përgjigjes janë raportuar për familjet, individët dhe ditarët. Tabela B2 tregon shkallët e përgjigjes për SSHPK-në, si dhe metodën e llogaritjes së tyre

Tabela B2: Shkallët e përgjigjes

Përshkrimi	Metoda e llogaritjes	Shkalla e përgjigjes (%)
<i>Shkalla e përgjigjes së familjeve</i>	Numri i familjeve të intervistuar / numri i familjeve të zgjedhura	91.5
<i>Shkalla e përgjigjes së individëve</i>	Numri i individëve që i'u përgjigjën pyetësorit individual / numri i individëve (objekt i studimit) në familjet e zgjedhura	88.4
<i>Shkalla e përgjigjes së ditarëve</i>	Numri i individëve të cilët plotësuan të paktën njërin prej ditarëve / numri i individëve (objekt i studimit) në familjet e zgjedhura	80.1
	Numri i ditarëve të plotësuar / (numri i individëve objekt i studimit * numri i ditëve të ditarit për individ)	78.2
<i>Shkalla neto e përgjigjes</i>	Numri i familjeve ku të gjithë anëtarët e familjes (objekt i studimit) kanë plotësuar ditarët në ditët e caktuara / numri i familjeve të zgjedhura	69.3

5 Shih <https://www.h2.scb.se/tus/tus/Introduction3.html#Part1>

6 Dokumenti i Eurostat-it DOC E2/TUS/5/98

Në lidhje me shumë studime të tjera kombëtare mbi përdorimin e kohës, rezultati i SSHPK-së për shkallët e përgjigjes është mjaft i mirë.

Tabela B3: Ditët e shtyra të ditarit

Numri i javëve të shtyrjes së ditëve të ditarit	Ditari 1	Ditari 2	Gjithsej	Ditari 1 (%)	Ditari 2 (%)	Gjithsej (%)
0	5,181	4,965	10,146	98.2	98.22	98.19
1	74	69	143	1.4	1.36	1.38
2	22	20	42	0.4	0.40	0.41
3	1	1	2	0.0	0.02	0.02
Gjithsej	5,278	5,055	10,333	100	100	100

Relativisht shumë pak ditarë nuk janë plotësuar në ditët origjinale të përzgjedhura. Rezultati është shumë i mirë.

Tabela B4: Shpërndarja e ditarëve sipas ditëve të javës

Dita e javës	Numri i ditarëve	%
E Hënë	1,085	10.5
E Martë	1,066	10.3
E Mërkurë	1,086	10.5
E Enjte	1,026	9.9
E Premte	1,023	9.9
E Shtunë	2,554	24.7
E Diel	2,493	24.1
Gjithsej	10,333	100

Rezultati është shumë i mirë.

Tabela B5: Shkallët e përgjigjes së ditarit

	% e peshuar	Frekuenca
Plotësuar të dy ditarët	85.6	5,039
Plotësuar vetëm ditar i parë (i ditë-javës)	4.9	239
Plotësuar vetëm ditar i dytë (i fundjavës)	0.2	16
Intervista e kryer por asnjë ditar i plotësuar	9.3	544
Gjithsej	100.0	5,838

Në një perspektivë ndërkombëtare rezultati është i arsyeshëm.

Koha e pallogaritur për ditar

Koha mesatare për kodin 999 “përdorimi i paspecifikuar i kohës” ishte 0.74 minuta në ditë.

Tabela B6: Numri mesatar i ngjarjeve (aktiviteti kryesor) sipas gjinisë, personat 10 vjeç e lart

	Mesatarja	Gabimi standart i mesatares	Mediana	Q1	Q3	Numri i ditarëve të plotësuar
Meshkuj	21	0.2	21	18	24	4,892
Femra	25	0.3	25	21	29	5,441
Gjithsej	23	0.2	23	19	27	10,333

Numri i episodeve të regjistruara në ditarë është i pranuar në përgjithësi si një tregues indirekt që tregon se sa në detaje janë plotësuar ditarët. Numri mesatar i episodeve në studimin shqiptar është paksa më i vogël sesa pritet të jetë por nuk është i ulët që të mos jetë i pranueshëm. Disa studime kombëtare që përdorin të njëjtën metodologji mbledhin më shumë episode për ditar, por ka dhe të tjerë që mbledhin më pak episode.

Tabela B7: Koha kur u plotësuan ditarët

	Meshkuj			Femra			Të gjithë		
	Nr i ditarëve	%	Mesatarja	Nr i ditarëve	%	Mesatarja	Nr i ditarëve	%	Mesatarja
Tani dhe gjatë ditës së ditarit	1,457	30	21	1,781	33	26	3,238	31	24
Në fund të ditës së ditarit	2,373	49	21	2,512	46	25	4,885	47	23
Një ditë pas ditës së ditarit	915	19	21	1,012	19	25	1,927	19	23
Më vonë, disa ditë pas ditës së ditarit	141	3	21	136	2	25	277	3	23
Vlera munguese	6	0	22	-	0		6	0	22
Gjithsej	4,892	100	21	5,441	100	25	10,333	100	23

Është provuar që koha kur janë plotësuar ditarët korrelojnë me cilësinë e të dhënave. Prandaj do ishte e dëshirueshme që ditarët të plotësohen tani dhe përgjatë ditës së ditarit dhe të paktën jo më vonë sesa në fund të ditës së ditarit. Në studimin shqiptar rreth 30 përqind e ditarëve u plotësuan gjatë ditës dhe rreth gjysma e tyre u plotësuan në fund të ditës së ditarit. Këtu ka vend për përmirësim. Por megjithatë nuk ka korrelacion me numrin e episodeve.

Sistemi i Klasifikimit të Aktiviteteve			
	Grupi kryesor i aktivitetit	Niveli dyshifror	Niveli treshifror
0	Kujdesi personal	Gjumë	Gjumë
			I sëmurë në shtrat
		Ngrënia	Ngrënia
			Pirja e kafeve
		Kujdesi tjetër personal	Larja dhe veshja
			Tjetër ose kudes personal i paspecifikuar
1	Punësimi Puna e paguar	Puna kryesore dhe e dytë	Orari i punës në punën kryesore dhe në punën e dytë
		Aktivitete që lidhen me punësimin	Vaktet e ushqyerjes në punë, pushimet e kafesë
			Aktivitete të tjera të lidhura me punësimin
2	Studimi	Shkolla ose universiteti	Orët e mësimit dhe leksionet
			Detyrat e shtëpisë
		Studimi i paspecifikuar	
		Studim/mësim në kohë të lirë	Studim/mësim në kohë të lirë
3		Kujdesi i paspecifikuar për njësinë ekonomike familjare dhe familjen	
		Manaxhimi i të ushqyerit	Gatimi, pjekja dhe përgatitja e turshive/konservimeve
			Larja e enëve
		Mirëmbajtja e njësisë ekonomike familjare	Pastrimi i shtëpisë
			Pastrimi i oborrit
			Ngrohja dhe uji
			Sistemimi i mallrave dhe materialeve të njësisë ekonomike familjare
		Punimi dhe kujdesi për tekstilet	Tjetër ose mirëmbajtja e paspecifikuar e njësisë ekonomike familjare
			Larja e rrobave
			Hekurosja
			Punimet artizanale dhe prodhimi i të tekstiltave
			Tjetër ose punimi dhe kujdesi për tekstilet i paspecifikuar

		Kopshtaria dhe kujdesi për kafshët shtëpiake	Kopshtaria
			Mbajtja e kafshëve shtëpiake
			Kujdesi për kafshët shtëpiake përkëdhelëse
			Nxjerrja e qenit në shëtitje
			Tjetër ose kopshtaria dhe kujdesi për kafshët i paspecifikuar
		Ndërtimi dhe riparimet	Ndërtimi dhe rinovimi i shtëpisë
			Riparimet e banesës
			Punimi, riparimet dhe mirëmbajtja e pajisjeve
			Mirëmbajtja e automjetit
			Tjetër ose ndërtime ose riparime të paspecifikuara
		Bërja e pazarit dhe shërbimet	Bërja e pazarit
			Shërbimet tregtare dhe administrative
			Shërbimet personale (vizita tek doktori, dentisti, etj)
			Tjetër ose bërja pazar dhe shërbimet të paspecifikuara
		Menaxhimi i njësisë ekonomike familjare	Menaxhimi i njësisë ekonomike familjare
		Kujdesi ndaj fëmijës	Kujdesi fizik dhe mbikqyrja
			Të mësuarit e fëmijës
			Leximi, loja dhe bisedat me fëmijën
			Shoqërimi i fëmijës
			Tjetër ose kujdesi i paspecifikuar ndaj fëmijës
		Kujdesi për të rriturit (për një anëtar të rritur të familjes)	Kujdesi fizik për një anëtar në ngarkim të rritur të familjes
			Kujdes tjetër ndaj një anëtar në ngarkim të rritur të familjes
			Ndihma ndja një anëtar të rritur jo në ngarkim të familjes
4	Puna vullnetare dhe takimet/mbledhjet	Puna organizative	Puna organizative (puna për ose nëpërmjet një organizate)
		Ndihma jo-formale ndaj njësive ekonomike familjare të tjera	Ndërtimi dhe riparimet si ndihmë
			Ndihma lidhur me punën dhe aktivitetet bujqësore
			Kujdesi për fëmijën e vet që jeton në një njësi tjetër ekonomike familjare
			Kujdes tjetër ndaj fëmijës si ndihmë ndaj një familjeje tjetër
			Ndihma e dhënë një personi të rritur të një familjeje tjetër
			Tjetër ose ndihma jo-formale e paspecifikuar ndja një njësie tjetër ekonomike familjare
		Aktivitetet pjesëmarrëse	Takimet
			Aktivitetet fetare
			Tjetër ose aktivitetet pjesëmarrëse të paspecifikuara

5	Jeta shoqërore dhe argëtimi	Jeta shoqërore	Shoqërimi me familjen
			Vizitat tek të tjerët dhe pritja e vizitorëve
			Festimet
			Bisedat telefonike
			Tjetër ose jeta shoqërore e paspecifikuar
		Argëtim dhe kulturë	Kinema
			Teatër dhe koncerte
			Ekspozitat artistike dhe muzeumet
			Biblioteka
			Ngjarjet sportive
6	Sportet dhe aktivitetet në natyrë	Ushtrimet fizike	Tjetër ose argëtimi dhe kultura të paspecifikuar
			Pushimi
			Shëtitje dhe marshim
			Vrapim dhe jogging
			Ngjarja e biçikletës, skitë dhe patinazhi
		Ushtrimet prodhuese	Lojërat me top
			Gjimnastikë dhe fitness
			Sportet në ujë
			Tjetër ose sporte dhe aktivitete në natyrë të paspecifikuara
			Ushtrimet prodhuese (p.sh gjahu, peshkimi, mbledhja e manaferrave, etj)
7	Hobi-të dhe përdorimi i kompjuterit	Artet dhe hobitë	Aktivitetet e lidhura me sportet
			Aktivitetet e lidhura me sportet
			Artet (pamore, ekzekutuese, letrare)
			Koleksionimi
		Informatikë dhe programim	Letërshkëmbimi
			Tjetër ose hobi të paspecifikuara
			Informatikë dhe programim
			Informimi nëpërmjet kompjuterit
		Lojërat	Komunikimi nëpërmjet kompjuterit
			Tjetër ose informatikë e paspecifikuar
8	Media	Leximi	Lojërat me letra, kumar
			Lojërat e salloneve
			Lojërat në kompjuter
		Shikimi i TV-së, Videos ose DVD-ve	Tjetër ose lojëra të paspecifikuara
			Leximi i periodikëve
			Leximi i librave
			Tjetër ose leximi i paspecifikuar
		Radio dhe regjistrimet	Shikimi i TV-së, Videos ose DVD-ve
			Dëgjimi i radios ose i regjistrimeve

9	Udhëtimi dhe përdorimi i paspecifikuar i kohës	Udhëtimi sipas qëllimit	Udhëtimi për në/nga puna
			Udhëtimi lidhur me studimin
			Udhëtimi lidhur me bërjen e pazarit dhe shërbimet
			Udhëtimi lidhur me kujdesin ndaj fëmijës
			Udhëtimi lidhur me kujdesin tjetër ndaj njësisë ekonomike familjare
			Udhëtimi lidhur me punën vullnetare dhe takimet
			Udhëtimi lidhur me jetën shoqërore
			Udhëtimi lidhur me aktivitetet tjera të kohës së lirë
			Udhëtimi lidhur me ndryshimin e vendndodhjes
			Tjetër ose qëllimi i paspecifikuar i udhëtimit

Sistemi i Klasifikimit të Aktiviteteve është përdorur për të gjithë aktivitetet, për aktivitetet kryesore dhe aktivitetet paralele.

Vendndodhja

Vendndodhja e paspecifikuar (jo në udhëtim)

Në shtëpi

Në shtëpinë e fundjavës ose në apartamentin e pushimit

Në vendin e punës ose në shkollë

Në shtëpinë e të tjerëve

Në restorant, kafe ose pub

Në qendra tregtare, tregje, dyqane të tjera

Në hotel, në shtëpinë e miqve, në kamping

Vendodhje tjetër e specifikuar (jo në udhëtim)

Mënyra e transportit

Udhëtim në këmbë

Udhëtim me biçikletë

Udhëtim me motoçikletë, motor ose motobarkë

Tjetër ose mënyrë e paspecifikuar e transportit privat

Transporti publik

SHTOJCA **D**

Disa karakteristika të të dhënave të marra nga ditaret mbi përdorimin e kohës

Natyra e të dhënave për përdorimin e kohës

Burimi: Instrumenti HETUS për gjenerimin e tabelës (<https://www.h2.scb.se/tus/tus/>)

Të dhënat për përdorimin e kohës mblidhen nëpërmjet ditareve. Të intervistuarit i regjistrojnë aktivitetet e tyre në disa ditare, duke përdorur fjalët e tyre. Ky ditar mbulon aktivitetin e tyre për 24 orë. Përveç disa përjashtimeve, çdo i intervistuar e plotëson ditarin për dy ditë. Në HETUS, instrumenti i ditarit regjistron të dhënat për katër fusha:

Aktiviteti kryesor: “Çfarë bëtë?”

Aktivitete paralele ose të dorës së dytë: “A keni bërë edhe ndonjë gjë tjetër? Nis po, çfarë?”

Me kë: “A ishit vetëm apo me një të njohur? N.q.s. ishit me dikë, kush ishte ky person?”

Vendi (duke përfshirë edhe mënyrën e transportit)

Si rrjedhojë, të dhënat konsistojnë në një sekuencë episodesh ose aktiviteteesh, të cilat karakterizohen secila nga këto katër fusha të regjistruara. Përveç kësaj, ka edhe *identifikues individual* dhe *të përkohshëm*. Identifikuesi individual (“identiteti i ditarit/ personit”) lidh një episod me informacione përgjithshme me familjen e të intervistuarit dhe me rrethanat e tij individuale. Identifikuesit e përkohshëm lidhin orën e fillimit me atë të mbarimit të episodit, dhe kështu, edhe kohëzgjatjen e një episodi të caktuar. Për të kuptuar se çfarë mund të ofrojnë të dhënat sa i përket analizimit, dhe këtu bëhet fjalë për një informacion të konsiderueshëm, vlen të mbahet parasysh struktura e të dhënave, d.m.th. sekuenca e episodeve.

Informacioni bazë mblidhet përmes intervistave. Ky informacion ka për qëllim të formojë grupet e popullsisë për të cilat llogaritet përdorimi i kohës.

Figura D1: Një shembull ditari

Identiteti i ditarit/ personit	Ora e fillimit	Ora e mbarimit	Aktiviteti kryesor	Aktivitet paralel	Me kë:				Ku/mënyra e transportit
					Vetëm	Me burrin/ gruan	Me fëmijë të vogël	Me persona të tjerë	
A	04:00	07:20	Gjumë						Në shtëpi
a	07:20	07:50	Dush						Në shtëpi
a	07:50	08:30	Hëngra mëngjesin	Lexova gazetën			F		Në shtëpi
a	08:30	08:40	Shkova deri tek autobusi		V				Në këmbë
a	08:40	09:00	Me autobus në punë					PT	Me autobus
a	09:00	11:20	Punë e paguar					PT	Në punë
a	11:20	11:50	Pushim dreke: hëngra drekë	Bisedova me një koleg				PT	Në punë
a	11:50	12:00	Pushim dreke: shëtitje në këmbë	Bisedova me kolegët				PT	Në këmbë
a	12:00	12:30	Pushim dreke: shëtitje në këmbë		V				Në këmbë
a	12:30	16:30	Punë e paguar					PT	Në punë
a	16:30	16:50	Me autobus në shtëpi	Lexova gazetën	V				Me autobus
a	16:50	17:00	Nga autobusi eca në këmbë		V				Në këmbë
a	17:00	17:40	Gatova darkën	Bisedë me fëmijët			F		Në shtëpi
a	17:40	18:20	Hëngra darkën	Bisedë me familjen		ME B/G	F		Në shtëpi
a	18:20	19:10	Lava enët	Dëgjova radion	V				Në shtëpi
a	19:10	21:00	Pashë televizor			ME B/G	F		Në shtëpi
a	21:00	22:10	Bëra një shëtitje	Bisedova me burrin/gruan		ME B/G			Në këmbë
a	22:10	22:20	Dush						Në shtëpi
a	22:20	04:00	Gjumë						Në shtëpi

Udhëzime për interpretimin e të dhënave statistikore

Të dhënat më thelbësore statistikore janë *koha mesatare për aktivitetet e ndryshme dhe raporti i individëve që kaluan disa kohë për kryerjen e aktiviteteve* gjatë ditës që ata mbajtën ditar (“shkalla e pjesëmarrjes”). Të gjitha të dhënat mund të llogariten për një sërë grupesh popullsie në varësi të informacioni bazë që mblidhet.

Koha mesatare për një aktivitet llogaritet si më poshtë: Le të marrim për shembull aktivitetin e *punës së paguar* dhe si grup popullsie *gratë*. Tani, për të gjitha ditaret e plotësuar nga *gratë*, mblidhet kohëzgjatja e të gjitha episodeve të punës së paguar. Atëherë, disa gra do të kontribuojnë më shumë orë pune të paguar, kurse të tjerat që nuk kanë bërë asnjë punë me pagesë ditën që është mbajtur ditar, nuk do të kontribuojnë në këtë shumë. Shuma, d.m.th. shuma e orëve të punës së paguar të të gjitha grave pjesëtohet me numrin total të grave (ose me numrin e ditareve të grave), pavarësisht nëse ato kanë kryer apo jo punë të paguar. Koha mesatare nuk përmban asnjë lloj informacioni lidhur me shpërndarjen e numrit të orëve të punës së paguar brenda këtij grupi popullsie. Në të njëjtën kohë, mesatarja mund të ketë edhe shpërndarje krejtësisht të ndryshme. Lë të supozojmë se koha mesatare e punës së paguar është 4 orë në ditë. Nëse të gjitha gratë punojnë 4 orë në ditë, mesatarja do të jetë 4 orë në ditë. Rezultati do të jetë i njëjtë nëse gjysma e grave punojnë 8 orë, kurse gjysma tjetër nuk punojnë fare. Si rrjedhojë, mesatarja i fsheh këto ndryshime.

Në këtë rast, mesatarja është një karakteristikë e grupit të popullsisë; *grupi i popullsisë* gra shpenzon i gjithë së bashku një numër të caktuar orësh pune të paguar. Nëse numri i orëve shpërndahet në mënyrë të barabartë brenda grupit, të gjitha gratë do të punonin 4 orë. Por, siç u përmend, shpërndarja mund të ketë edhe një formë tërësisht të ndryshme.

Tani, nëse mesataret e dy grupeve popullsie ndryshojnë nga njëra-tjetra, kjo do të thotë se një nga *grupet e popullsisë*, d.m.th. *të gjithë* individët e grupit *së bashku*, kalojnë më shumë kohë për të kryer një punë të paguar.

Disa informacione për shpërndarjen gjenden edhe tek shkalla e pjesëmarrjes, d.m.th. raporti i individëve që i kushtojnë një kohë të caktuar këtij aktiviteti. Nëse ky raport është 100 për qind, të gjithë kryejnë një punë të paguar, nëse është 50 për qind, gjysma e tyre, e kështu me radhë nëse dy grupe popullsie kanë të njëjtën mesatare, por shkallë të ndryshme pjesëmarrjeje, mund të arrihet në përfundimin se individët që i përkasin grupit të popullsisë me shkallën më të ulët të pjesëmarrjes kanë punuar mesatarisht më shumë orë sesa ata që i përkasin grupit tjetër të popullsisë, në qoftë se këta të fundit kanë punuar. Kjo e dhënë, koha mesatare për ata që e kanë kryer në fakt këtë aktivitet, gjendet shpesh në publikimet statistikore për përdorimin e kohës. Duhet theksuar se kjo e dhënë fsheh edhe shpërndarjen pas tyre.

Të dhënat në nivel grupi

Të intervistuarit e plotësojnë ditarin për një ose për dy ditë që caktohen në mënyrë të rastësishme. Në këtë mënyrë, studiohen momente të shkurtra dhe të rastësishme të jetëve të njerëzve. Ato nuk mund të konsiderohen si përfaqësuese të individëve të veçantë. Prandaj, të dhënat për përdorimin e kohës kanë kuptim vetëm kur ato

llogariten për grupe individësh me një masë të konsiderueshme. Grupet formohen nëpërmjet informacionit të mbledhur nëpërmjet intervistave. Grupet e rëndësishme të popullsisë janë grupet në bazë të gjinisë, moshës, stadi në ciklin familjar, numrit të fëmijëve, etj. Në këtë sistem mund të formohen këto dhe grupe të tjera popullore.

Interpretimi i *fushave të regjistruara*

Kërkimet kanë treguar se në ditare nevojitet të aplikohen disa lloje të dhënash kronologjike të episodeve – si në rastin e HETUS – për të marrë të dhëna të besueshme për përdorimin e kohës.

Në sistemin HETUS, të intervistuarit i regjistrojnë aktivitetet e tyre në ditar duke përdorur fjalët e tyre. Kjo bëhet për një ose për dy ditë të përzgjedhura në mënyrë të rastësishme. Në rast se kryhen dy aktivitete në të njëjtën kohë, ditari ka vend për t'i regjistruar të dyja, një *aktivitet kryesor* dhe një *aktivitet sekondar* (ose paralel). Fusha e tretë që regjistrohet është *prania e personave të tjerë*. Si rrjedhojë, episodi i regjistruar në ditar karakterizohet nga një *aktivitet kryesor* dhe ndoshta edhe një *aktivitet sekondar*, si dhe nga informacioni mbi praninë e personave të tjerë. Një identifikues i përkohshëm jep informacion rreth orës dhe kohëzgjatjes së çdo episodi. Në fazën kur aktivitetet në ditar janë të koduara, informacioni mbi *vendndodhjen*, d.m.th. vendin ku ka ndodhur aktiviteti mund të nxirret dhe të kodohet në disa kategori të ndryshme. Kjo fushë përmban edhe informacione mbi mjetet e transportit.

Episodi është një njësi që jep informacion për sjelljen. Fushat e regjistrimit, të marra një nga një apo në kombinime të ndryshme, ofrojnë informacione mbi aspekte të ndryshme të sjelljes së njerëzve. Kur të dhënat përdoren për përshkrime statistikore dhe për të analizuar atë çka bëjnë njerëzit, çfarë aktivitete kryejnë, ofrohen qasje të shumfishta alternative. Qasja që duhet zgjedhur varet nga objektivat – cili aspekt sjelljeje na intereson, dhe kështu zgjidhet edhe episodi që i korrespondon një interesi të caktuar.

Le të supozojmë se aspekti që na intereson është *ngrënia e një vakti*. Mund të jetë e mjaftueshme që të zgjidhen të gjitha episodet në kolonën e episodeve, për të cilat aktiviteti (pra përgjigja e pyetjes së ditarit “Çfarë bëtë?” ose aktiviteti sekondar (“A keni bërë ndonjë gjë tjetër?”) është *ngrënia e një vakti*. Nëse i intervistuari ka ngrënë vetëm apo i shoqëruar nga persona të tjerë, ku ka ngrënë dhe nëse ka bërë në të njëjtën kohë edhe një aktivitet tjetër, p.sh. leximi i një gazete, nuk ka lidhje me pyetjen, kështu që aktiviteti kryesor dhe sekondar së bashku mund të ofrojnë informacione të nevojshme dhe të mjaftueshme për klasifikimin e duhur të episodit. Megjithatë, nëse do të duhet të merreshim vetëm me aktivitetin kryesor, do t'i përjashtonim rrethanat ku personi që plotësoi ditarin kishte ngrënë dhe kishte parë televizor në të njëjtën kohë, por i ka dhënë prioritet shikimit të televizorit në plotësimin e ditarit; si rrjedhojë, *të ngrënit e një vakti* do të dilte më pak në numër.

Një shembull i dytë. Disa vite më parë, në një media suedeze u raportua se suedezët kalonin 2 minuta në ditë *duke biseduar me fëmijët*. Kjo bazohej në një shifër të

gjetur në një tabelë statistikore të publikuar në një raport mbi një sondazh suedez për përdorimin e kohës. Shifra në vetvete është korrekte, por interpretimi i saj është krejtësisht i gabuar.

Interpretimi korrekt do të ishte: kur një mostër e rastësishme, nxjerrë nga të dhënat e regjistruara në ditare të popullsisë suedeze (20-64 vjeç) në sistemin HETUS mbi llojet e aktiviteteve që kryejnë dhe mbi kohën që ata u kushtojnë këtyre aktiviteteve (gjatë një dite të çfarëdoshme), rezultati është që kohëzgjatja mesatare totale prej dy minutash përshkruhet me fjalë që tregojnë qartë se aktiviteti kryesor ka qenë të biseduarit me fëmijët. Megjithatë, *kjo nuk do të thotë se nuk ka pasur asnjë bisedë tjetër me fëmijët*. Për të llogaritur se sa kohë kalojnë njerëzit duke biseduar me fëmijët e tyre, nevojitet një qasje tjetër. Parimisht, çdo episod në kolonën e episodeve, duhet të analizohet dhe të klasifikohet duke pasur parasysh nëse ka apo jo gjasa që gjatë atij episodi të bisedohet me fëmijët. Për shembull, le ta zëmë se një e intervistuar është nënë me një fëmijë. Aktiviteti kryesor i nënës është *ngrënia e një vakti* ku është i pranishëm edhe fëmija. Në kolonën e aktiviteteve sekondare nuk regjistrohet asnjë aktivitet sekondar, atëherë ka më shumë të ngjarë që nëna të flasë me fëmijën, dhe jo e kundërta. Pra, për të llogaritur kohën e të biseduarit me fëmijët, duhen identifikuar të gjitha episodet gjatë të cilave mund të bisedohet me fëmijët, duhet shënuar kohëzgjatja dhe duhet llogaritur mesatarja. Informacioni që duhet shfrytëzuar për të gjetur të gjitha episodet e duhura gjendet në totalin e fushave të regjistrimit, jo vetëm në një prej tyre. Si ta shfrytëzojmë informacionin që gjendet në fushat e regjistrimit varet nga qëllimi i analizës. Për qëllime të caktuara, mjafton sigurisht që analiza të kufizohet në njërën ose në tjetrën fushë të regjistrimit.


Shembull i një aktiviteti disi më të ndërlikuar është *kujdesi për fëmijët*. Kuptimi i këtij koncepti përcakton se si të nxirret ai nga të dhënat e ditarit. Nëse kujdesi për fëmijët përkufizohet si aktivitetet që përfshijnë në mënyrë direkte fëmijët ose drejtohen direkt tek ata, si të ushqyerit, vënia e fëmijës në gjumë, ndërrimi i pelenave, etj., mund të jetë e mjaftueshme që të përzgjidhen episodet që karakterizohen nga kodet e aktiviteteve kryesore që tregojnë këto aktivitete të veçanta. Nëse, nga ana tjetër, kujdesi për fëmijët jepet në një kuptim më të gjerë, p.sh. formimi i kapitalit njerëzor dhe social i fëmijës, duhet të shtohen edhe episode të tjera. Do të duhet, sigurisht, të merren në konsideratë edhe fushat e regjistrimit, aktivitetet paralele dhe “me kë ose në prani të kujt kryhen aktivitetet”.

Figura 2 përcakton disa nga vlerat e mundshme për llogaritjen e kujdesit për fëmijët. Së pari është koha primare që i kushtohet kujdesit për fëmijët. Të dhënat suedeze 2000/01 tregojnë se nënat me fëmijë deri në moshën shtatë vjeç i kushtojnë pak më shumë se dy orë, kurse baballarët përkatës pak më shumë se një orë në ditë kujdesit për fëmijët si një aktivitet primar.

Tani shtojmë kujdesin për fëmijët si një aktivitet sekondar, dhe totali rritet në tre orë për nënat dhe një orë e gjysmë për baballarët. Por shumë më e rëndësishme është koha që prindërit kalojnë jo të angazhuar në aktivitete qartësisht të lidhura me fëmijët, por gjithsesi në praninë e fëmijëve të tyre.

Nëse përfshihen edhe vaktet me fëmijët, shtohet edhe një orë. Nëse aktivitetet e nënës në kohën e lirë në praninë e fëmijëve konsiderohen si kujdes për fëmijën, atëherë shtohen edhe dy orë të tjera. Dhe përfundimisht, nëse i konsiderojmë punët e shtëpisë me praninë e fëmijëve, na dalin tetë orë kujdes për fëmijët në ditë, katër herë më shumë sesa 2 orëshi fillestar i kujdesit për fëmijët nëpërmjet aktiviteteve primare. Për baballarët, kjo shifër rritet nga rreth 1 orë në ditë në pak më shumë se pesë orë.

Figura 2: Koha mesatare për lloje të ndryshme të kujdesit për fëmijët. Prindërit e martuar apo që bashkëjetojnë me fëmijë të vegjël, 0-6 vjeç. Popullsia suedeze 2000/01



Cila prej këtyre përbën bazën e duhur për llogaritjen e masës së sigurimit të shërbimeve të kujdesit për fëmijët jashtë tregut? Aktiviteti primar i vetëm kuptohet që është i pamjaftueshëm. Por totali i kohës kur është i pranishëm edhe fëmija, është pa diskutim i tepruar, sidomos për shkak se mund të përfshijë edhe praninë e të dy prindërve me një fëmijë të vetëm. Sërish, objektivi na orienton.

Thelbi është: përzgjidhni të gjitha episodet që lidhen me qëllimin. Ky sistem ua ofron këtë mundësi përdoruesve të përparuar.

Ndryshimet në strukturë përkundrejt sjelljes

Interpretimi i ndryshimeve të kohës mesatare të kaluar për një aktivitet apo për një tjetër midis disa grupeve të popullsisë dhe/ose midis vendeve të ndryshme, nuk është gjithmonë i drejtpërdrejtë. Diferencat nuk janë domosdoshmërisht shprehje të diferencave në sjellje. Këto diferenca ose ndryshime mund të shpjegohen edhe me ndryshimet në struktura, ose me një kombinim të të dyjave.

Le të supozojmë se ka një ndryshim në përdorimin e kohës nga nënat me fëmijë të vegjël (nën 7 vjeç) që janë të martuara ose që bashkëjetojnë në dy vende. Përveç kësaj, supozojmë se ka ndryshime në përbërjen e grupeve të popullsisë. Në një vend, shkalla e fertilitetit është relativisht më e lartë dhe mosha mesatare e grave në lindjen e parë më e ulët krahasuar me vendin tjetër. Si rrjedhojë, mosha mesatare e nënave është më e vogël dhe numri mesatar i fëmijëve është më i madh në njërin nga vendet. Nëse mosha dhe numri i fëmijëve ndikojnë tek përdorimi i kohës, rezultati midis dy vendeve do të ishte i ndryshëm edhe nëse nuk ka ndryshime në përdorimin e kohës, duke pasur parasysh moshën e barabartë të nënave dhe numrin e njëjtë të fëmijëve. Kështu, në këtë rast, nuk ka ndryshime në sjellje, por vetëm në përbërjen e grupeve të popullsisë.

